

UDHËZUESI PËR PËRZGJEDHJEN E STUDIMEVE NË UNIVERSITETET PUBLIKE DHE PRIVATE NË SHQIPËRI

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT
E FËMIJËVE DHE TË RINJVE

JANAR, 2024



UDHËZUESI PËR PËRZGJEDHJEN E STUDIMEVE NË UNIVERSITETET PUBLIKE DHE PRIVATE NË SHQIPËRI

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit "QËNDRO në Shkollë" zbatuar nga UNICEF me mbështetjen financiare të qeverisë italiane, nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë. Në kuadër të projektit "QËNDRO në Shkollë", Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve është angazhuar për "Orientimin e adoleshentëve dhe të rinjve në zgjedhjen e studimeve akademike në Universitetet e Shqipërisë".

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ambasada Italiane në Tiranë nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet e shprehura në këtë material. Përgjegjësia për përmbajtjen e tij i takon tërësisht autorit.

ISBN

978-9928-4811-0-8



MIRËNJOHJE

“Udhëzuesi për Përzgjedhjen e Studimeve në Universitetet Publike dhe Private” ka për qëllim orientimin e maturanëve, kandidatëve dhe të rinjve në lidhje me hapat që duhet të ndjekin përpara përzgjedhjes së programit të studimit, gjatë aplikimit dhe pas përzgjedhjes si fitues.

Hartimi i tij ka kaluar nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm pune, me takime konsultative si dhe me përfaqësim ndërinstitucional të nivelit vendor dhe qendror. Ky Udhëzues mundësohet falë vëmendjes dhe mbështetjes së zyrës së UNICEF-it në Shqipëri në kuadër të projektit “Orientimi i adoleshentëve dhe të rinjve në zgjedhjen e studimeve akademike në Universitetet e Shqipërisë” që po zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

Ai u përgatit nga znj. Eridjona Vallja (Observatori) dhe znj. Elma Tërshana (Observatori) në bashkëpunim me z. Bernard Zeneli (konsulent).

Falënderime dhe mirënjohje i shkojnë për kontributin dhe ekspertizën e ofruar në finalizimin e këtij udhëzuesi, znj. Zamira Gjini – Ministria e Arsimit dhe Sportit; z. Arjan Xhelaj - Rrjeti Akademik Shqiptar; znj. Albana Alija (mësuese). Ky Udhëzues u përpunua dhe u redaktua nga z. Besnik Rama, specialist në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilin e falënderojmë për kontributin dhe punën profesionale.

Ekipi i punës falënderon znj. Linda Bushati – UNICEF, për gjithë mbështetjen e dhënë.

Janar, 2024



TABELA E PËRMBAJTJES

MIRËNJOHJE	3
I. HYRJE: KËSHILLIMI PËR KARRIERËN	7
I.1. Si të aplikosh për në universitet?	7
II. KONSULTIMI DHE MARRJA E VENDIMIT	9
II.1. Si të konsultohemi me mësuesit?	9
II.2. Si të konsultohemi me prindërit?	10
II.3. Si të konsultohemi me këshilluesin e karrierës?	11
II.4. Si të marrim vendime për përzgjedhjen e 10 programeve të studimit?	12
III. MUNDËSITË PËR TË APLIKUAR	14
III.1. Mundësitë për të aplikuar sipas notës mesatare të shkollës së mesme dhe të provimeve të Maturës Shtetërore	14
III.2. Mundësitë për të aplikuar sipas prirjeve individuale	24
III.3. Mundësitë për të aplikuar sipas kushteve financiare	24
IV. PROCESI I APLIKIMIT DHE AFATET	25
IV.1. Afatet e aplikimit	25
IV.2. Institucione dhe “fjalë të rëndësishme”	26
V. DHJETË HAPAT E APLIKIMIT	29
V.1. Familjarizimi me procesin e aplikimit	29
V.2. e-Albania dhe plotësimi i formularëve për maturën dhe studimet universitare	29
V.3. Përgatitja për provimet e maturës	30
V.4. Familjarizimi me universitetet dhe kolegjet	30
V.4.1. Marrja e informacionit për universitetet shtetërore dhe private	30
V.4.2. Marrja e informacionit për universitetet shtetërore dhe private	32
V.5. Provimet e Maturës Shtetërore	32
V.6. U-Albania: Përzgjedhja e programeve të studimit - raundi i parë	32
V.7. U-Albania: Përlllogaritja e pikëve, publikimi i listave dhe regjistrimet - raundi i dytë	37

V.7.1.	Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të kandidatëve	37
V.7.2.	Procesi i regjistrimit në raundin e dytë	39
V.7.3.	Procesi i çregjistrimit në raundin e dytë	40
V.8.	Klasifikimi i programeve të studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik - raundi i tretë	41
V.9.	Finalizimi i regjistrimit në universitetin e përzgjedhur	42
V.10.	Fillimi i studimeve	42
VI.	SHTET APO PRIVAT?	44
VI.1.	Përfitimet e studimeve në universitetet private dhe shtetëror	44
VI.2.	Përfitimi i bursave sipas kategorive në nevojë dhe të ekselencës në universitetet shtetërore	45
VI.2.1.	Fondi i mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë në universitetet shtetërore	45
VI.2.2.	Fondi i Ekselencës për nëpunësit civilë dhe studentët e shkëlqyer në universitetet shtetërore	47
VI.2.3.	Përrjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit në universitetet shtetërore	49
VI.2.4.	Masa e bursës për studentët në universitetet shtetërore	50
VI.3.	Përfitimi i bursave sipas kategorive në nevojë dhe të ekselencës në universitetet private	51
VI.3.1.	Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer në universitetet private	51
VI.3.2.	Bursat e promovimit në universitetet private	51
VI.3.3.	Bursat sociale për studentët në universitetet private	52
VI.3.4.	Bursat e talentit dhe lidërsipit	52
VI.3.5.	Masa e bursës për studentët në universitetet private	52
VI.4.	Përzgjedhja e studimeve në Tiranë apo në rrethe?	52
VII.	SHTOJCA	54
VII.1.	Shtojca A - Informacion për universitetet	54
VII.1.1.	Universitetet shtetërore në Shqipëri	54
VII.1.2.	Universitetet Private në Shqipëri	57
VII.2.	Shtojca B - Referenca	61

LISTA E SHKURTIMEVE

AKFAL	<i>Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë</i>
DPAP	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar</i>
DRAP	<i>Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar</i>
IAL	<i>Institucionet e Arsimit të Lartë</i>
IAP	<i>Institucionet e Arsimit Parauniversitar</i>
KMCA	<i>Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë</i>
MAS	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit</i>
Observatori	<i>Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve</i>
QSHA	<i>Qendra e Shërbimeve Arsimore</i>
RASH	<i>Rrjeti Akademik Shqiptar</i>
UT	<i>Universiteti i Tiranës</i>
VKM	<i>Vendim i Këshillit të Ministrave</i>
ZVAP	<i>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</i>



I. HYRJE:

KËSHILLIMI PËR KARRIERËN

I.1. Si të aplikosh për në universitet?

Procesi i aplikimit për studime universitare në Shqipëri kalon nëpër disa hapa. Këta hapa janë të njëjtë për sa u takon fazave të para të aplikimit, por ndryshojnë kur kalohet në fazat e mëtejshme që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e programit të studimit dhe universitetin.

Udhëzuesi ju vjen në ndihmë në procesin e aplikimit për studime universitare. Aplikimi për studime universitare në Shqipëri nuk është një vendim thjesht individual. Nëse jeni ju në fund që do të bëni përzgjedhjen si maturant apo maturanthe, ardhja të vendimmarrja kalon përmes proceseve të ndryshme dhe përfshin edhe diskutime dhe marrje mendimesh nga prindërit, mësuesit, rrethi i gjerë familjar, shoqëria etj.

Udhëzuesi ka për qëllim që t'ju paraqesë hapat e përgjithshëm nëpër të cilët kalon procesi i vendimmarrjes për të zgjedhur programin e studimeve dhe përfshin orientim për këto fusha. Për universitet në Shqipëri mund të ndryshojë lehtësisht midis universiteteve dhe programeve të ndryshme, por këto janë disa hapa të përgjithshëm që mund të përfshijnë:

- 1 Përzgjedhjen e programit të studimeve dhe universitetin.**
Gjatë kësaj faze, ju do të identifikoni 10 programe studimi dhe universitete për të cilat keni interes duke u bazuar në dëshirat dhe përparësitë personale dhe kërkesat përkatëse të programit dhe universitetit që keni zgjedhur.
- 2 Plotësimi i formularëve të aplikimit.**
Gjatë kësaj faze, ju familjarizoheni me formularët e ndryshëm që duhen plotësuar në platformat online e-Albania dhe U-Albania dhe përgatitni informacionet përkatëse për të plotësuar formularët. Gjatë kësaj faze, ju mësoni edhe për kërkesat specifike për programe të ndryshme studimi apo për formularë shtesë që mund të kenë universitete të ndryshme.
- 3 Dokumentacioni.**
Më pas, ju vijoni me sigurimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme të cilat përfshijnë të dhënat e kartës suaj të identitetit dhe informacione që lidhen me rezultatet tuaja shkollore, provimet e maturës etj.
- 4 Pagimi i tarifave të aplikimit:**
Procesi i aplikimit për në universitet nuk është falas. Ai ka tarifa të caktuara që bëhen në fillim të procesit. Po ashtu, universitetet kanë tarifa vjetore që duhen paguar.

5 *Procesi digjital i aplikimit:*

Procesi i aplikimit kalon nëpër disa faza digjitale që përmbillen me përzgjedhjen e programit dhe me regjistrimin fizik në programin e përzgjedhur në universitetin ku keni aplikuar. Në disa raste, mund të ketë edhe provime shtesë për programe të caktuara, përveç provimeve të Maturës Shtetërore.

6 *Rezultatet e aplikimit:*

Procesi i aplikimit, siç e theksuam, kalon nëpër disa faza. Nëse ju nuk përzgjidheni në fazën e parë për programin e studimeve që dëshironi, kaloni edhe disa faza të tjera përzgjedhjeje që kombinojnë programet tuaja të preferuara dhe rezultatet shkollore e ato të provimeve të maturës.

7 *Regjistrimi fizik në universitet:*

Procesi i aplikimit mbyllet me regjistrimin fizik në programin e përzgjedhur duke dorëzuar të dhënat individuale dhe duke kryer proceset e regjistrimit.

Lexoni me kujdes të gjitha udhëzimet dhe afatet e aplikimit për universitetin specifik për të cilin jeni të interesuar, pasi këto mund të ndryshojnë nga një institucion në tjetrin.



II. KONSULTIMI DHE MARRJA E VENDIMIT

II.1. Si të konsultohemi me mësuesit?

Konsultimi me mësuesit mund të jetë një hap i rëndësishëm në procesin e zgjedhjes së programit të studimeve në universitet. Mësuesit kanë njohuri të mira për aftësitë dhe interesat e nxënësve dhe mund të ofrojnë këshilla mjaft të vlefshme. Këtu janë disa hapa që mund të ndiqni:

- 1 Planifikoni një takim individual:**
Kërkoni një takim individual me mësuesin e lëndës së caktuar apo ndonjë mësues që ka njohuri në fushën e studimeve të interesit tënd. Ky takim do të mundësojë një bisedë të thellë mbi shqetësimet dhe interesat e tua.
- 2 Diskutoni për aftësitë dhe interesat tuaja:**
Ndani me mësuesit aftësitë tuaja, interesat dhe ambiciet. Mësuesit mund të jenë në gjendje të ofrojnë këshilla të personalizuar duke u nisur nga njohuritë e tyre për ju si nxënës.
- 3 Informohuni për programet dhe fushat e studimit:**
Mësuesit kanë njohuri të thella për programet dhe fushat e studimit. Pyetini ata për detaje mbi programet e ndryshme, mundësitë për specializim dhe sfidat që mund të hasni në secilin program.
- 4 Kërkoni këshilla për zgjedhjen e programit të studimit:**
Pyetini mësuesit për mendimin e tyre lidhur me përshtatshmërinë tuaj me programin e studimit që ju intereson. Ata mund të ofrojnë këshilla mbi atë se çfarë mund të pritët në fushën specifike të studimit dhe për perspektivën tuaj pas studimeve.
- 5 Hulumtoni për mundësitë e punësimit:**
Diskutoni me mësuesit lidhur me mundësitë e punësimit në programin e studimit që jeni të interesuar. Ata mund të ndajnë informacion mbi mundësitë e punësimit, sfidat dhe këshilla praktike për të arritur sukses në atë fushë.
- 6 Përgatisni një listë me pyetje:**
Përgatisni një listë me pyetje për takimin tuaj me mësuesit, duke përfshirë çdo dyshim ose pyetje që keni lidhur me zgjedhjen e programeve të studimeve.

Kujdesuni që të bëni një bisedë të hapur dhe të jeni të përgatitur për të ndarë me mësuesit informacion mbi nevojat, synimet dhe sfidat tuaja, duke i lejuar kështu ata të ofrojnë këshilla më të përshtatshme për ju.



II.2. Si të konsultohemi me prindërit?

Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e aplikimit për në universitet. Ndhma dhe mbështetja e tyre janë shumë të rëndësishme për suksesin tuaj. Mos harroni që, për shumicën prej jush, prindërit do të jenë dhe mbështetësit financiarë gjatë viteve të studimit. Ka disa mënyra se si prindërit mund të ndihmojnë në këtë proces:

- 1 Këshillim dhe orientim:**
Prindërit mund të ofrojnë këshillim dhe orientim për zgjedhjen e programit të studimit dhe të universitetit. Ata mund t'ju ndihmojnë të identifikoni fushat e interesit dhe të zbuloni mundësitë e studimit në universitete të ndryshme.
- 2 Mbështetje financiare:**
Për shumë prej jush, financat janë një çështje e rëndësishme. Prindërit mund të ndihmojnë në përgatitjen tuaj financiare dhe mund të jenë të gatshëm për t'ju mbështetur ju (fëmijën) në këtë periudhë. Kjo përfshin diskutime rreth kostove të shkollës, bursave dhe alternativave për kredi.
- 3 Ndhma për aplikimin:**
Prindërit mund të ndihmojnë në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për aplikim. Gjithashtu, ata mund të jenë një burim këshillash për studimin gjatë provimeve të Maturës Shtetërore dhe në proceset e mëtejshme të aplikimit.
- 4 Monitorimi i afateve:**
Aplikimi për në universitet ka afate të caktuara. Prindërit mund të ndihmojnë duke siguruar që ju të ndiqni afatet dhe të dorëzoni dokumentet në kohë.
- 5 Përgatitja për provimet e Maturës Shtetërore:**
Prindërit mund të ndihmojnë në përgatitjen tuaj për këto provime duke ofruar mbështetje emocionale dhe këshilla praktike.
- 6 Mbështetja emocionale:**
Procesi i aplikimit për në universitet mund të jetë stresues për ju dhe prindërit mund t'ju ofrojnë mbështetje emocionale duke ju dëgjuar dhe duke ju ndihmuar në menaxhimin e stresit.
- 7 Vizita në universitete:**
Edhe pse nuk është zakon në Shqipëri, ju rekomandojmë që, nëse është e mundur, prindërit t'ju bashkohen në vizitat në kampuset universitare. Kjo mund t'ju ndihmojë ju dhe prindërit tuaj të keni një perceptim më të qartë për mjedisin e universitetit dhe në vendimmarrjen për përzgjedhjen e universitetit.

Përmbushja e këtyre hapave ju ndihmon në krijimin e një mjedisi mbështetës për ju dhe prindërit duke e bërë procesin e aplikimit më të lehtë dhe më të suksesshëm.

II.3. Si të konsultohemi me këshilluesin e karrierës?

Konsultimi me këshilluesin e karrierës është një hap i rëndësishëm për të marrë udhëzime dhe këshilla profesionale në zgjedhjen e programit të studimeve universitare. Këshilluesit e karrierës janë të trajnuar për të ofruar ndihmë në identifikimin e aftësive, interesave dhe objektivave të nxënësve. Në vijim kemi përmbledhur disa hapa për t'u konsultuar me këshilluesin e karrierës:

1 Kërkoni një takim individual:

Kontaktoni zyrën e këshilluesit të karrierës në shkollën tuaj dhe bëni një takim zyrtar për të diskutuar rreth programit të studimit. Shumica e shkollave kanë një strukturë të përcaktuar për takime me këshilluesit e karrierës.

2 Përgatituni për takimin:

Përpara takimit, përgatisni një listë me pyetje dhe informacion rreth interesave tuaj, aftësive dhe synimeve për karrierë. Kjo do t'ju ndihmojë të përfitoni maksimumin nga takimi.

3 Identifikoni qartë interesat tuaj për punësim dhe karrierë:

Diskutoni me këshilluesin rreth fushave tuaja të interesit. Këshilluesi mund t'ju ndihmojë të identifikoni lidhjet mes interesave tuaj dhe programeve specifike të studimit. Përveç zgjedhjes së programit të studimit, merrni nga këshilluesi këshilla lidhur me zhvillimin e karrierës dhe mundësitë për praktikë apo përvojë pune.

4 Analizoni me këshilluesin aftësitë tuaja:

Këshilluesi i karrierës mund t'ju ndihmojë të analizoni aftësitë tuaja për të parë si mund të përshatën ato me fushat e studimit dhe karrierën.

5 Diskutoni rreth mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve:

Këshilluesi i karrierës mund t'ju ndihmojë të kuptoni mundësitë e karrierës në fushat e studimit që po hulumtoni. Diskutoni rreth mundësive të punësimit dhe zhvillimit të karrierës.

6 Pyetni për programet e studimit dhe universitetet:

Kërkoni informacion rreth programeve të studimit, universiteteve dhe mundësive për studime të mëtejshme jashtë vendit.

7 Këshilla për procesin e aplikimit:

Këshilluesi i karrierës mund t'ju ndihmojë gjatë procesit të aplikimit, përfshirë regjistrimin në U-Albania dhe realizimin e një aplikimi të suksesshëm.

8 Gjurmimi i afateve dhe rregullave:

Diskutoni për afatet e aplikimit dhe për rregullat e ndryshme që duhet të ndiqni gjatë procesit të aplikimit.

Takimi me këshilluesin e karrierës duhet të jetë një proces i hapur dhe i ndërgjegjshëm, ku ju dhe këshilluesi bashkëpunoni për të gjetur zgjedhjen më të mirë për ju.

II.4. Si të marrim vendime për përzgjedhjen e 10 programeve të studimit?

Zgjedhja e 10 degëve të studimit është një proces i rëndësishëm dhe mund të jetë sfidues. Në vijim janë disa këshilla që mund t'ju ndihmojnë të kryeni këtë zgjedhje:

- 1 Identifikoni interesat tuaj:**
Mendoni për fushat dhe programet që ju interesojnë më shumë. Identifikimi i interesave tuaj të vërtetë do të jetë një udhërrëfyes i mirë për zgjedhjen e programit së studimit.
- 2 Analizoni aftësitë tuaja:**
Reflektoni mbi aftësitë dhe talentin tuaj natyror. Përcaktojeni se ku jeni të mirë dhe çfarë ju kënaq më shumë. Kini parasysh rezultatet gjatë viteve të studimit dhe shikoni lëndët ku keni rezultatet më të larta.
- 3 Merrni në konsideratë notën mesatare të shkollës së mesme:**
Jini realist në marrjen e vendimeve duke pasur parasysh si notën mesatare të shkollës së mesme, ashtu edhe programet e përzgjedhura. Në portalin U-Albania, ju mund të shikoni të dhënat statistikore dhe të përlllogarisni shanset që keni për të fituar programin e studimeve që dëshironi në bazë të mesatares me të cilën janë regjistruar studentët në vitin pararendës.
- 4 Parashikoni provimin me zgjedhje që do të jepni në Maturën Shtetërore dhe rezultatet e pritshme:**
Reflektoni mirë për notat tuaja dhe mësoni formulat që përdoren për përzgjedhjen e programit të studimeve që bëhet automatikisht në portalin "U-Albania".
- 5 Konsideroni perspektivat e punësimit:**
Hulumtoni perspektivat e karrierës në fushat që po mendoni të studioni. Disa programe mund të ofrojnë mundësi të mëdha për punësim dhe zhvillim karriere, ndërsa disa të tjera mund të kenë një treg të ngushtë pune.
- 6 Bëni një listë krahasuese:**
Përgatitni një listë dhe shënoni 10 fushat e mundshme të studimit që ju interesojnë. Për secilën fushë, shkruani arsyet pse e keni zgjedhur atë dhe si mendoni se do të ndihmojë në arritjen e synimeve tuaja.
- 7 Konsultohuni me këshilluesin e karrierës:**
Takoni këshilluesin e karrierës për të diskutuar ide dhe shqetësime. Ai mund t'ju ofrojë këshilla të specializuara duke u nisur nga njohuritë e tij dhe nga përvoja.
- 8 Merrni njohuri specifike për programet e studimit:**
Lexoni më shumë rreth programeve të studimit që keni në listën tuaj. Kuptoni përmbajtjen e programit të studimit, strukturën e kursit dhe mundësitë për specializim.
- 9 Bëni vizita në universitete:**
Nëse është e mundur, vizitoni kampuset e universiteteve që keni në listë. Kjo mund t'ju ndihmojë të njihni mjedisin dhe atmosferën ku do të studioni.
- 10 Bisedoni me studentët aktualë:**
Pyetni studentët aktualë që studiojnë në fushat që po hulumtoni. Ata mund t'ju japin një informacion më të qartë rreth programit dhe kërkesave të studimeve.

11 **Vlerësoni situatën e tregut të punës:**

Kuptoni situatën e tregut të punës për fushat që ju interesojnë. Një analizë e kujdesshme e mundësive për punësim mund të ndihmojë në zgjedhjen e një programi studimi me perspektiva të mira për punësim.

Pamundësia për të zgjedhur si duhet 10 programet e studimit mund të çojë në kërkesa të kufizuara ose të vështira, kështu që përpiquni të identifikoni programet që përputhen më së miri me interesat, aftësitë dhe synimet tuaja të punësimit.



III. MUNDËSITË PËR TË APLIKUAR

III.1. Mundësitë për të aplikuar sipas notës mesatare të shkollës së mesme dhe të provimeve të Maturës Shtetërore

Nota mesatare e shkollës së mesme dhe rezultatet e provimeve të maturës luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mundësitë që ka maturanti për të aplikuar në një program studimi në universitet. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përlllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si vijon: "mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë, mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore". Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përlllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në QShA.

Të gjitha kushtet për mesataren:

- Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, mund të konkurrojnë kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare nga nota 6.5 dhe në vijim.
- Për të konkurruar në disa prej programeve të gjuhëve të huaja për vitin e ri akademik kërkohet mesatare e shkollës së mesme nga nota 7 dhe më lart. Në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, në konkurrim kërkohet që maturanti të ketë minimalisht notë mesatare 7.5.
- Për programet Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci, Stomatologji mund të konkurrojnë vetëm maturantët dhe kandidatët e tjerë që kanë mesatare të shkollës së mesme duke nisur nga nota 8.5 dhe në vijim.
- Për programin Shëndet Publik mund të konkurrojnë maturantët dhe kandidatët e tjerë që kanë mesatare të shkollës së mesme duke nisur nga nota 8 dhe më lart.
- Për programet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike mund të konkurrojnë maturantët dhe kandidatët e tjerë që kanë mesatare të shkollës së mesme duke nisur nga nota 7.5 dhe më lart.
- Për programet Teknikë dentare, si dhe Higjienist dentar mund të garojnë maturantët dhe kandidatët e tjerë që kanë mesatare të shkollës së mesme duke nisur nga nota 7 dhe më lart.

Rast konkret sesi ndikon mesatarja dhe matura në përzgjedhjen e studimeve

Universiteti i Tiranës (UT) është universiteti më i madh dhe më i vjetër publik në Republikën e Shqipërisë. Në të studiojnë rreth 25.000 studentë në të tri ciklet e studimit.

Në përbërjen e tij, Universiteti i Tiranës ka 6 fakultete përkatësisht:

- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
- Fakulteti i Ekonomisë dhe
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Në përbërjen e tij UT-ja ka dhe Filialin e Universitetit në Sarandë.

Më poshtë pasqyrohen kriteret e pranimeve për studimin në të gjitha fakultetet e këtij Universiteti, referuar tri cikleve të studimit (Bachelor, Master profesional, Master i shkencave).



FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË



PROGRAMI I STUDIMIT

Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në

- Histori
- Gjuhë Letërsi
- Gjeografi
- Gazetari me profile: Gazetari sociale kulturore, Gazetari politike, Gazetari ekonomike
- Arkeologji

Cikli i dytë Master i shkencave

- Gjuhësi me profile:
 - i. Gjuhësi e Sotme
 - ii. Gjuhësi Historike
- Studime Letrare, me profile:
 - i. Teori letërsie dhe kritikë letrare
 - ii. Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar
 - iii. Studime letrare dhe antropologji kulturore
- Histori
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Trashëgimi Kulturore
- Arkeologji
- Gjeografi
- Gazetari dhe Komunikim me profile:
 - i. Marrëdhënie publike
 - ii. Gazetari evropiane dhe ndërkombëtare
 - iii. Komunikimi ndërkulturor
 - iv. Marketing mediatic
 - v. Drejtimi dhe menaxhimi i mediave

Cikli i dytë Master profesional

- Mësuesi në Histori për arsimin e mesëm
- Mësuesi në Gjeografi për arsimin e mesëm
- Mësuesi në Gjuhë Letërsi për arsimin e mesëm
- Arkivistikë
- Redaktori
- Guidë turistike
- Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar

KRITERET

- 4.1 Nota mesatare aritmetike (e *thjeshtë*) e tre viteve të shkollës mesme vlerësohet **80%**
- 4.2 Nota mesatare aritmetike (e *thjeshtë*) e provimeve të Maturës Shtetërore vlerësohet **20%**

Fakulteti i historisë dhe filologjisë - <https://www.fhf.edu.al/>

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS



PROGRAMI I STUDIMIT

Programet të ciklit të parë të studimeve Bachelor në:

- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Bioteknologji
- Fizikë
- Biologji
- Kimi
- Kimi Industriale e Mjedisore
- Kimi dhe Teknologji Ushqimore
- Informatikë
- Matematikë
- Inxhinieri Matematike dhe Informatikë

Cikli i dytë Master profesional

- Bioteknologji Mjedisore
- Informatikë Biznesi
- Inxhinieri Matematike dhe Informatike
- Teknologji Informacioni

Cikli i dytë Master i shkencave

- Biologji Mjedisore
- Biologji Molekulare
- Fizikë
- Bioteknologji Molekulare dhe Industriale
- Kimi Industriale dhe Mjedisore
- Inxhinieria Proceseve Kimike
- Shkencat dhe Teknologjitë ushqimore
- Kimi me profilin Analiza kimike dhe vetite e lëndës
- Inxhinieri Matematike dhe Informatike
- Informatikë
- Matematikë
- Mësues në Kimi për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Biologji për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Fizike për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësues në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Mësues në Informatikë për Arsimin e Mesëm të Lartë

KRITERET

2.1 Programi i studimit **Biologji**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **70% të vlerësimit**
- b. Nota e Biologjisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%
- c. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

2.2 Programi i studimit **Bioteknologji**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **70% të vlerësimit**
- b. Nota e Biologjisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%
- c. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

2.3 Programet e studimit **Kimi, Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Kimisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- c. Nota mesatare e Biologjisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- d. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Kimisë 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%
- f. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

2.4 Programi i studimit **Matematikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 30%
- c. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%

2.5 Programi i studimit **Fizikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- c. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- d. Nota mesatare e Kimisë (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Fizikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%
- f. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 10%

2.6 Programi i studimit **Informatikë**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 15%
- c. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 5%
- d. Nota mesatare e TIK (kurrikul bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje, viti III) 20%

2.7 Programi i studimit **Inxhinieri Matematike dhe Informatike**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 30%
- c. Nota e provimit të Matematikës në Maturë Shtetërore 10%
- d. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje viti III) 10%

2.8 Programi i studimit **Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), përbën **50% të vlerësimit**
- b. Nota mesatare e Matematikës (kurrikul bërthamë viti I+II+III) 15%
- c. Nota mesatare e Fizikës (kurrikul bërthamë viti I+II) 5%
- d. Nota mesatare e TIK (kurrikula bërthamë viti I+II) 10%
- e. Nota e Matematikës 12 (kurrikul me zgjedhje viti III) 20%

Për programet e studimit **Bachelor Informatikë** dhe **Bachelor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**, profilet e shkollave (Gjimnaz, Harry Fultz Elektronikë, Peter Mahringer Teknologji Informacioni, Inxhinieri Informatike Softwareash-Gmeiner, Elektronikë në Teknologjinë e Automatizimit) do të kenë koeficient 1. Profilet e shkollave të mesme të tjera do të kenë koeficient **0.8**.

FAKULTETI I EKONOMISË



PROGRAMI I STUDIMIT

Programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në

- Financë
- Ekonomiks
- Informatikë Ekonomike
- Administrim Biznesi

Cikli i dytë Master i shkencave

- Administrim Biznesi, me profile:
 - i. Menaxhim
 - ii. Menaxhim i Burimeve Njerëzore
- Administrim Publik
- Marketing
- Financë me profil:
 - i. Drejtues financiar
 - ii. Ndërmjetës bankar
 - iii. Ndërmjetës jobankar
- Kontabilitet dhe Auditim
- Ekonomiks
- Sisteme Informacioni në Ekonomi
- Kërkime Operacionale në Menaxhim
- Siguria e informacionit
- Menaxhim Turizmi
- Menaxhim Risku
- Statistika Zyrtare

Cikli i dytë Master profesional

- Administrim-Biznes
- Administrim-Publik
- Marketing
- Menaxhim Turizmi
- Financë
- Kontabilitet dhe Auditim
- Studime Ekonomike Evropiane
- Sisteme Informacioni në Ekonomi
- Financë, Kontabilitet dhe Auditim
- Teknologji e Informacionit në Menaxhimin e Proceveve të Biznesit
- Analizë dhe Administrim Fiskal

KRITERET

- 6.1 Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë) përbën **50 % të vlerësimit**
- 6.2 Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore) përbën **50 % të vlerësimit**:
- | | |
|----------------|-----|
| a. Matematikë | 15% |
| b. Ekonomi | 15% |
| c. Fizikë | 10% |
| d. Gjuhë e hua | 10% |

FAKULTETI I DREJTËSISË



PROGRAMI I STUDIMIT

Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor / Program i integruar

- Drejtësi

Cikli i dytë Master i shkencave

- Drejtësi, me profil "E Drejtë Civile"
- Drejtësi, me profil "E Drejtë Penale"
- Drejtësi, me profil "E Drejtë Publike"

Cikli i dytë Master profesional

- E Drejtë Civile
- E Drejtë Penale
- E Drejtë Publike
- EU Business Law

KRITERET

Nota mesatare e përgjithshme e të gjithë viteve të shkollës së mesme **40%**
 Nota mesatare e të gjithë provimeve të maturës shtetërore **10%**

Lëndët formuese:

- | | |
|---|-----|
| a. Gjuhë Shqipe (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) | 10% |
| b. Gjuhë e huaj, e parë (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) | 10% |
| c. Letërsi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e provimit MSH) | 10% |
| d. Qytetari (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) | 5% |
| e. Histori (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) | 5% |
| f. Ekonomi (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH nëse e ka dhënë) | 5% |
| g. Matematikë (të gjitha vlerësimet përfshirë dhe notën e MSH) | 5% |

Koeficienti i shkollës së mesme

- Të gjitha shkollat e mesme gjimnaze (përfshirë gjimnazin me kohë të shkurtuar) e kanë **koeficientin 1.2**
- Të gjitha shkollat e mesme me karakter profesional e kanë **koeficientin 1.0**

Fakulteti i ekonomisë - <https://feut.edu.al/>
 Fakulteti i Drejtësisë - <https://fdut.edu.al/>

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROGRAMI I STUDIMIT

Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në

- Gjuhë Angleze me profile:
gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane
- Gjuhë Frënge me profile:
gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Gjermane me profile:
gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Italiane me profile:
gjuhë dhe komunikim, gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Turke me profile:
gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Ruse me profile:
gjuhë, letërsi dhe qytetërim rus, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Spanjolle me profile:
gjuhë, letërsi dhe qytetërim hispanik
- Gjuhë Greke me profile:
gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim

Cikli i dytë Master i shkencave

- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik
- Përkthim Teknik-Letërar dhe Interpretim
- Mësuesi në Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi në Gjuhë Italiane për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi në Gjuhë Frënge për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi në Gjuhë Gjermane për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi në Gjuhë Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi në Gjuhë Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë

Cikli i dytë Master profesional

- Përkthim, me profil: Përkthyes

KRITERET

7.1 Nota mesatare aritmetike (e thjeshtë) e tre viteve të shkollës së mesme, përfshirë dhe notat e Maturës Shtetërore **përbën 100%**, për programet e studimit:

- Gjuhë frënge
- Gjuhë italiane
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë spanjolle
- Gjuhë turke
- Gjuhë greke
- Gjuhë ruse
- Gjuhë angleze

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



PROGRAMI I STUDIMIT

Programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor në

- Punë Sociale
- Psikologji
- Shkenca Politike
- Administrim dhe Politikë Sociale
- Filozofi
- Sociologji

Cikli i dytë Master i shkencave

- Përkatesi Gjinore dhe Zhvillim
- Administrim i Shërbimeve Sociale
- Shërbime Sociale në Drejtësinë Penale
- Çështje të Fëmijëve dhe të Familjes
- Komunikimi për Ndryshimin Social dhe të Sjelljes
- Studime Rajonale Politike
- Psikologji Shkollore
- Psikologji Organizacionale
- Psikologji Klinike
- Filozofi Sociale
- Shkenca Politike me profil: Teori politike
- Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore
- Punë Sociale, me profile:
 - i Drejtimit klinik
 - ii Organizim komunitar
 - iii Politikë sociale
- Mësuesi në Shkenca Sociale për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Etika në Institucione dhe leadership
- Shkenca të Edukimit
- Politika dhe Drejtimit Arsimi
- Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja

Cikli i dytë Master profesional

- Punë Sociale e Avancuar (2 drejtime):
 - i Punë Sociale në Arsim
 - ii Punë Sociale në Shëndetësi
- Analizë e Politikave Sociale
- Qeverisje dhe Politika Publike
- Sociologji Edukimi
- Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë
- Filozofi Praktike dhe Humane
- Këshillim Psikologjik
- Orientim Profesional
- Pedagogji e Specializuar Sociale
- Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim
- Psikologji Ligjore

KRITERET

Koeficienti i shkollës së mesme

Shkollat e kategorive gjimnaz, gjimnaz dygjuhësh shqip-italisht, shqip-gjermanisht dhe shqip-frëngjisht kanë **koeficientin 1.4**

Shkollat e kategorive pedagogjike, gjimnaz gjuhësor, shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe shkolla administrim biznes kanë **koeficientin 1.2**

Gjithë shkollat e tjera të kategorive profesionale kanë **koeficientin 1**

Kriteret e pranimit

- 3.1 Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme **40%**
- 3.2 Nota mesatare aritmetike e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje të MSH **30%**
 - Për maturat që japin provim me zgjedhje lëndët Qytetari, Psikologji ose Filozofi- Sociologji aplikohet **koeficienti 1.2**
 - Për maturat që nuk japin një nga këto lëndë në provimet me zgjedhje aplikohet **koeficienti 1**.
- 3.3 Nota mesatare aritmetike e gruplëndëve formuese në shkencat sociale përbën **30%**
 - a. Qytetari dhe Filozofi (kurrikul bërthamë klasa 10 e 11)
 - b. Psikologji dhe Sociologji (kurrikul me zgjedhje, klasa 12)
 - për maturantët që kanë zgjedhur në klasën e 12 si lëndë me zgjedhje Psikologji ose Sociologji, ose të dyja, aplikohet **koeficienti 1.2**
 - maturantëve që nuk kanë zgjedhur në klasën e 12 si lëndë me zgjedhje Psikologji ose Sociologji, ju llogaritet thjesht mesatarja e lëndëve të zhvilluara nga fusha e shkencave sociale (kurrikul bërthamë, Qytetari dhe Filozofi, klasa 10 e 11)

Fakulteti i gjuhëve të huaja – <https://fgjh.edu.al/>
Fakulteti i Shkencave Sociale – <https://fshs-ut.edu.al/>

Përlllogaritja e pikëve për renditjen e kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit në universitet

Përlllogaritja e pikëve për renditjen e kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit në universitet del automatikisht në sistemin U-Albania. Megjithatë, më poshtë paraqitet formula e përlllogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të renditjes së kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit të integruara "Mjekësi e Përgjithshme" të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025.

$$PP = 70\% * PAM + 30\% * PTI$$
$$PP = \{ (PTI * KPTI * 30\%) + (((M1 * 30) + ((NF1 + NF2 + NF3 * KLZ) / 3) * 10 + ((NB1 + NB2 + NB3 * KLZ) / 3) * 10 + ((NK1 + NK2 + NK3 * KLZ) / 3) * 10 + ((D1 + D2 + D3 + Z1 * KZ1) / 4) * 40) * KSHM * 100 * 70\% \}$$

SHPJEGIM:

PP	<i>Pikë të përgjithshme për renditje</i>
PAM	<i>Pikët e fituara nga arsimi i mesëm</i>
PT1	<i>Pikët e fituara nga testi i informatizuar</i>
KPTI	<i>Koeficienti i pikëve të testimit të informatizuar</i>
M1	<i>Nota mesatare aritmetike e thjeshtë për të gjitha vitet e shkollë së mesme</i>
NF1	<i>Nota përfundimtare e lëndës Fizikë në vit të parë</i>
NF1	<i>Nota përfundimtare e lëndës Fizikë në vit të parë</i>
NF2	<i>Nota përfundimtare e lëndës Fizikë në vit të dytë</i>
NF3	<i>Nota përfundimtare e lëndës Fizikë në vit të tretë</i>
NB1	<i>Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të parë</i>
NB2	<i>Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të dytë</i>
NB3	<i>Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të tretë</i>
NK1	<i>Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të parë</i>
NK2	<i>Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të dytë</i>
NK3	<i>Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të tretë</i>
KLZ	<i>Koeficienti i lëndëve me zgjedhje të vitit të tretë, Kimi, Biologji, Fizikë, nota shumëzohet me koeficient 1.25</i>
D1	<i>Provimi i detyruar i maturës 1</i>
D2	<i>Provimi i detyruar i maturës 2</i>
D3 Z1	<i>Provimi i detyruar i maturës 3</i>
Z1	<i>Provim me zgjedhje i maturës 1</i>
KZ1	<i>Koeficienti i lëndës me zgjedhje në Maturën Shtetërore do të jetë si më poshtë: Provime mature me zgjedhje lëndët Kimi, Fizikë, Biologji, KZ=1.4 Të gjitha lëndët e tjera KZ=1</i>
KSHM	<i>Koeficienti i shkollës së mesme</i>

Në tabelën e mëposhtme paraqiten koeficientet sipas llojit të shkollës së mesme që kanë përfunduar kandidatët, të cilët aplikojnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2024-2025:


NR	LLOJI I SHKOLLËS SË MESME	KOEFICIENTI
1	GJIMNAZ	1.4
2	SEKSIONE DYGJUHËSHE SHQIP-FRËNGJISHT	1.4
3	SEKSIONE DYGJUHËSHE SHQIP-ITALISISHT	1.4
4	SEKSIONE DYGJUHËSHE SHQIP-GJERMANISHT	1.4
5	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	1
6	GJIMNAZE GJUHËSORE	1
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	1
8	SHKOLLË SPORTIVE	1
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	1
10	HOTELERI-TURIZËM	1
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	1
12	MEKANIKË	1
13	ELEKTROTEKNIKË	1
14	ELEKTRONIKË	1
15	PËRPUNIM DRURI	1
16	NDËRTIM	1
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	1
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1
19	BUJQËSI	1

20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	1
21	VETERINARI	1
22	GJEODEZI	1
23	INSTALUES I SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	1
24	LLOGARI	1
25	SHËRBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TË DHËNASH	1
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE NË TIK	1
29	ELEKTRONIKË NE TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZMIT	1
30	SILVIKULTORË	1
31	HARRY FULTZ, BIZNES	1
32	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	1
33	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	1
34	PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI	1
35	PROFILE TË TJERA QË NUK JANË TË LISTUARA	1


Ju sjellim në vëmendje se koeficientet për llojin e shkollës se mesme janë të ndryshëm për çdo universitet.




- 5 Githësesi informacione më të zgjeruara përsa i përket kritereve hyrëse që lidhen me mesataren e notave të gjimnazit për të gjitha universitetet dhe programet e studimit në ciklin e parë të studimeve, mund t’i konsultoni në portalin U-Albania duke klikuar ikonën “Kriteret”.




- 5 Klikoni fillimisht dhe zgjidh universitetin.



- 5 Pastaj zgjidhni programin kriteret e të cilit dëshironi të shikoni



- 5 Po të shtypni butonin (+) mund të përzgjidhni një program të ngjashëm nga një universitet tjetër dhe të krahasoni kriterin e mesatares dhe të notave të tjera për të njëjtin program/të ngjashëm në dy apo më shumë universitete të ndryshme.



III.2. Mundësitë për të aplikuar sipas prirjeve individuale

Prirjet individuale luajnë një rol të rëndësishëm në zgjedhjen e fushës së studimit në universitet. Nëse zgjedhja e programit të studimit përputhet me prirjet dhe interesat individualë, ju keni më shumë mundësi për sukses dhe kënaqësi në rrugën tuaj të arsimit universitar. Në vijim kemi parashtruar disa pika se si mund të ndikojnë prirjet individuale në zgjedhjen e studimeve universitare:

- 1 Identifikimi i interesave:**
Prirjet individuale përfshijnë interesat, pasionet dhe fushat e preferuara të aktivitetit. Studentët duhet të mendojnë thellësisht rreth atyre aktiviteteve që i gëzojnë më shumë dhe që ndihen të motivuar të mësojnë më shumë për to.
- 2 Gjurmimi i talenteve dhe i prirjeve të veçanta:**
Talente të ndryshme mund të shfaqen në fusha të caktuara, si arti, shkencat, teknologjia, sporti, apo ndonjë fushë tjetër. Identifikimi dhe shfrytëzimi i këtyre talenteve mund të çojë në një zgjedhje të përshtatshme të fushës së studimit.
- 3 Analiza e aftësive:**
Ju duhet të analizoni aftësitë tuaja natyrore dhe ato që keni zhvilluar me kalimin e kohës. Njohja e aftësive do t'ju lejojë të përzgjidhni një fushë studimi që përputhet më mirë me aftësitë tuaja.
- 4 Studimet e avancuara, pjesëmarrja në olimpiada dhe përshtatshmëria me karrierën:**
Ju duhet të mendoni për kërkesat e tregut të punës dhe përshtatshmërinë e studimeve me kërkesat e punësimit të mundshëm. Ka shumë zhvillime dinamike dhe të shpejta në tregun e punës në Shqipëri i cili sa vjen dhe bëhet më i hapur, më konkurrues dhe më inovativ. Studimet që ofrojnë mundësi të mira për përparim dhe përshtatjen me tregun e punës, mund të jenë një zgjedhje e mirë.
- 5 Kërkimi i informacionit rreth programeve të studimit:**
Duke shqyrtuar detajet rreth programeve të studimit, ju mund të identifikoni ato që ofrojnë lëndë dhe tematika që ju interesojnë më shumë.
- 6 Konsultimi me këshilluesin e karrierës:**
Mund të duket e përsëritur, por ne ju rekomandojmë shumë që të diskutoni me këshilluesit e karrierës në shkollë apo jashtë saj, sepse ata mund t'ju ndihmojnë të identifikoni prirjet dhe zgjedhjen e një programi studimi që përputhet me to. Këshilluesi mund të ofrojë informacion mbi programet e studimit dhe mundësitë për punësim në fusha të ndryshme.

Zgjedhja e programit të studimit duhet të reflektojë një kombinim të prirjeve individuale, aftësive dhe synimeve për të siguruar një përvojë të pasur dhe të kënaqshme studimi në universitet.

III.3. Mundësitë për të aplikuar sipas kushteve financiare

Universitetet shtetërore dhe ato private kanë tarifa të ndryshme për kryerjen e studimeve universitare dhe pasuniversitare. Për informacione më të përditësuara në lidhje me tarifat e kryerjes së studimeve, çdo kandidat i interesuar duhet të ndjekë faqet zyrtare të universitetit/ fakultetit përkatës.

IV. PROCESI I APLIKIMIT DHE AFATET

IV.1. Afatet e aplikimit

KALENDARI I APLIKIMIT UNIVERSITAR 2023

RAUNDI I

RAUNDI II

10 → 27 <small>KORRIK KORRIK</small> PAGESA E TARIFAVE Kohëzgjatja 18 ditë	29 → 3 <small>KORRIK GUSHT</small> APLIKIMI ONLINE - PËRZGJEDHJA E 10 PROGRAMEVE TË STUDIMIT - Kohëzgjatja 6 ditë	27 <small>GUSHT</small> PUBLIKIMI I RENDITJES SË APLIKANTËVE NË U ALBANIA Kohëzgjatja 1 ditë	29 → 14 <small>GUSHT SHTATOR</small> PAGESA E TARIFAVE Kohëzgjatja 17 ditë	15 → 17 <small>SHTATOR SHTATOR</small> APLIKIMI ONLINE - PËRZGJEDHJA E 10 PROGRAMEVE TË STUDIMIT - Kohëzgjatja 3 ditë	21 <small>SHTATOR</small> PUBLIKIMI I RENDITJES SË APLIKANTËVE NË U ALBANIA Kohëzgjatja 1 ditë
28 <small>GUSHT</small> ANKIMIMI Kohëzgjatja 1 ditë	29 → 11 <small>GUSHT SHTATOR</small> REGJISTRIMI NË IAL / PUBLIKIMI NË KOHË REALE I RENDITJES (7 FAZA 48 ORËSHE) Kohëzgjatja 14 ditë	12 → 13 <small>SHTATOR SHTATOR</small> ÇREGJISTRIM NGA RAUNDI I PARË NË IAL Kohëzgjatja 2 ditë	22 → 1 <small>SHTATOR TETOR</small> REGJISTRIMI NË IAL / PUBLIKIMI NË KOHË REALE I RENDITJES (5 FAZA 48 ORËSHE) Kohëzgjatja 10 ditë	2 → 3 <small>TETOR TETOR</small> ÇREGJISTRIMI NGA RAUNDI I DYTË NË IAL Kohëzgjatja 2 ditë	4 → 10 <small>TETOR TETOR</small> KËRKESË DHE REGJISTRIMI PRANË IAL-ëve PAVARËSISHT APLIKIMEVE NË PORTALIN U ALBANIA Kohëzgjatja 7 ditë

***Kujdes: Kalendarin miratohet me urdhër të titullarëve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për çdo vit akademik, dhe publikohet para datës së fillimit të aplikimeve.**



IV.2. Institucione dhe “fjalë të rëndësishme”

1 **Matura Shtetërore**

Shërbim elektronik, i cili mundëson aplikimin me formularët A1 dhe A1Z.

2 **Portali qeveritar i Maturës Shtetërore**

Matura Shtetërore - Ministria e Arsimit dhe Sportit

Është njësia digjitale që përmban informacionet për Maturën Shtetërore në sistemin e-Albania.

3 **Qendra e Shërbimeve Arsimore**

QShA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve.

4 **U-Albania**

Portali U-Albania është vitrina kryesore e universiteteve për të prezantuar ofertën e tyre akademike. Që nga viti 2016, U-Albania numëron 38 universitete publike dhe private, dhe informacione të detajuara për 561 programe studimi të ciklit të parë të studimeve në Republikën e Shqipërisë. Portali U-Albania është ura lidhëse mes maturantëve dhe botës akademike. Nëpërmjet portalit, maturantët njihen me kriteret, programet, aplikimin universitar dhe regjistrimin në programin ku janë shpallur fitues.

Portali U-Albania përmban informacion lidhur me:

- Universitetet
- Programet e studimit
- Kriteret e pranimit
- Kuotat dhe tarifat
- Formularin e aplikimit
- Sekretarinë online të regjistrimit në universitet.

Për hapat që duhet të ndiqen për aplikimin dhe regjistrimin, orientohuni me videot informuese, manualin dhe infografikun.

5 **e-Albania**

e-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke shërbyer kështu si një pikë e vetme hyrëse për qytetarët 24/7 dhe është e lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit që është arkitektura themelore që lejon ndërveprimin midis 60 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

6 **Formularët e aplikimit (A1/A1Z, A2)**

Formularë aplikimi për regjistrimin në Maturën Shtetërore.

Formulari A1 plotësohet nga maturantët e këtij viti shkollor, ndërsa formulari A1Z plotësohet nga të gjithë kandidatët që duan të aplikojnë në Maturën Shtetërore, por që kanë mbaruar shkollën e

mesme para vitit shkollor që vazhdon. Formulari A2 plotësohet nga maturantët/kandidatët për të hyrë në universitet, sipas parimit meritë - preferencë.

7 *Universitet*

Universiteti është një institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi në fusha të ndryshme, si shkenca, teknologjia, inxhinieria, biznesi, shëndetësia etj., në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë. Në disa universitete janë të hapura edhe programet e studimit profesional. Në Shqipëri, universitetet janë publike ose private dhe të gjitha ofrojnë programe të ndryshme të studimit

9 *Kolegj profesional*

Kolegji profesional i lartë ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese, që zgjasin një ose dy vite akademike me ngarkesë përkatësisht 60 ose 120 kredite ECTS dhe që finalizohen me lëshimin përkatësisht të një certifikate ose diplome profesionale.

10 *Fakultet*

Fakulteti është një njësi akademike përbërëse e universitetit ose kolegjit që ofron programet studimore në fusha të caktuara, si: shkencat natyrore, sociale, ekonomike, inxhinierike etj. Fakulteti përmbledh brenda vetes drejtime të afërta akademike dhe shkencore.

11 *Diplomë*

Është dokumenti zyrtar i cili lëshohet në përfundim të studimeve të një niveli të caktuar apo në përfundim të studimeve me sukses të një programi studimesh në universitet.

12 *Program studimi*

Programi i studimit është një plan i organizuar i kurrikulës dhe i aktiviteteve të tjera akademike që studentët duhet të ndjekin për të marrë një diplomë universitare. Programet e studimit janë të ndara në fusha të ndryshme studimi dhe organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë – ose: Bachelor, Master dhe Doktoratë.

13 *10 preferencat për programe studimesh*

Programet e studimit që përzgjidhen nga maturantët/kandidatët për fillimin e studimeve në universitet.

14 *Ministria e Arsimit dhe Sportit*

Ministria që përfaqëson institucionin qeveritar që udhëheq çështjet e arsimit dhe sportit në Shqipëri. Kjo ministri është përgjegjëse për bërjen e politikave arsimore dhe menaxhon sistemin arsimor në Shqipëri. Ky institucion menaxhon edhe proceset e aplikimit për në universitetet përmes agjencive specifike.

13 *Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

14 *Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar*

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) është një institucion që ofron shërbime arsimore në nivel vendor. Ajo mund të ofrojë informacione dhe ndihmë për çështje, si regjistrimi i studentëve, bursat dhe shumë të tjera. Nëse keni nevojë për ndihmë specifike, mund të kontaktoni ZVAP-në në qytetin tuaj.

15 *Rrjeti Akademik Shqiptar*

Është institucioni që mirëmban portalin "U-Albania".

16 *Mësuesi përgjegjës për këshillimin në karrierë*

Mësuesi përgjegjës për këshillimin në karrierë është një profesionist i arsimit që ndihmon nxënësit në zgjedhjen e karrierës së tyre. Këshillimi në karrierë mund të përfshijë diskutime mbi aftësitë dhe interesat e nxënësve, mundësitë e punësimit, trajnimin dhe zhvillimin e karrierës, si dhe planifikimin e karrierës. Në shumicën e rasteve, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës janë përgjegjës për këshillimin në karrierë në gjimnaz. Këshillimi për karrierë mund të zhvillohet gjatë tri viteve të gjimnazit, por kryesisht në klasën e 12-të.



V. DHJETË HAPAT E APLIKIMIT

V.1. Familjarizimi me procesin e aplikimit

Procesi i aplikimit për në universitet është një moment i rëndësishëm për jetën e çdo maturanti apo maturanteje. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm, që fillon që në klasën e 10-të, është familjarizimi me procesin e aplikimit për në universitet duke ndjekur hapat e këtij procesi në sistemin e aplikimit në Shqipëri.

Nëse ju vendosni të studioni jashtë shtetit, janë hapa të tjerë që duhet të merrni parasysh në varësi të vendit ku doni t'i kryeni studimet.

Me rëndësi në fillim janë:

1. Përzgjedhja e universitetit dhe programit të studimeve.
2. Familjarizimi me sistemin dhe platformat digjitale të aplikimit.
3. Konsultimet me prindër, mësues dhe shoqërinë.
4. Ndjekja e orëve të këshillimit të karrierës apo konsultimet individuale.
5. Planifikimi i procesit dhe i hapave që do të ndërmerren.
6. Sigurimi i fondeve financiare për të përmbushur detyrimet financiare të aplikimit.
7. Plani i studimit për provimet e Maturës Shtetërore dhe për lëndët me zgjedhje në vitet e larta të arsimit të mesëm të lartë.

V.2. e-Albania dhe plotësimi i formularëve për maturën dhe studimet universitare

“Matura Shtetërore” është një shërbim elektronik, i cili mundëson aplikimin me formularët A1 dhe A1Z. Formulari A1 plotësohet nga maturantët e këtij viti shkollor, ndërsa formulari A1Z plotësohet nga të gjithë kandidatët që duan të aplikojnë në Maturën Shtetërore.

Hapi i parë është plotësimi i formularëve A1/A1Z në të cilin ruhen të dhënat personale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me provimet. Formularët A1/A1Z plotësohen fillimisht online nëpërmjet portalit e-Albania dhe më pas duhet të konfirmohen në shkollën përkatëse nga vetë maturanti/kandidati. Pas plotësimit të formularit bëhet korigjimi i pasaktësive, sipas një formulari të dërguar në shkollë nga QShA-ja për këtë qëllim. Gjatë muajit qershor zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore, bazuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS).

Maturantët që rezultojnë kalues në të gjitha provimet, pajisen me diplomë të Maturës Shtetërore.

Hapat e procedurës:

- Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania.
- Zgjidhni shërbimin “Matura Shtetërore” (një shërbim elektronik, i cili mundëson aplikimin e formularëve A1 dhe A1Z).

- Klikoni butonin “Përdor”.
- Zgjidhni llojin e formularit të aplikimit (maturantët duhet të zgjedhin A1, ndërsa kandidatët A1Z) dhe plotësoni të gjitha të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular, në të cilin ruhen të dhënat personale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me provimet.
- Klikoni butonin “Dërgo” në fund të formularit.
- Pasi përfundon me sukses aplikimin në portalin www.e-albania.al, maturanti/kandidati paraqitet në shkollë për të përfunduar dhe konfirmuar aplikimin.

V.3. Përgatitja për provimet e maturës

Përgatitja për provimet e Maturës Shtetërore mund të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë. Koha e nevojshme për përgatitje mund të ndryshojë nga personi në person, varësisht nga faktorë, si: niveli i njohurive, koha e disponueshme për përgatitje dhe strategjitë e përdorura për të mësuar.

- Nëse dëshironi të mësoni më shumë rreth përgatitjes për provimet e Maturës Shtetërore, ju mund të vizitoni faqen zyrtare të Maturës Shtetërore.
- Nëse dëshironi të merrni ndihmë nga profesionistët, mund të konsideroni të merrni leksione private ose të bashkëpunoni me një grup studimi. Nëse dëshironi të përgatiteni vetë, hartoni një plan pune duke përcaktuar një orar të rregullt për të mësuar.
- Përveç kësaj, mund të përdorni burime të tjera, si libra, aplikacione dhe uebfaqe që mund t’ju ndihmojnë në përgatitjen tuaj, siç mund të jetë Akademi.al.

V.4. Familjarizimi me universitetet dhe kolegjet

Për t’u familjarizuar me universitetet dhe kolegjet, publike dhe private, është krijuar një hapësirë informuese rreth programeve të tyre të studimit, kritereve të programeve etj., në portalin U-Albania duke aksesuar në adresën: www.ualbania.al. Të gjitha imazhet e pasqyruara më poshtë janë marrë nga portali U-Albania, në mënyrë që të pasqyrohet vizualisht çdo hap që duhet të ndiqet nga maturantët dhe kandidatët e interesuar për t’u familjarizuar me universitetet shtetërore dhe private në Shqipëri.

V.4.1. Marrja e informacionit për universitetet shtetërore dhe private


- Fillimisht, aksesohet portali U-Albania, në adresën www.ualbania.al
- Pasi të hapet faqja përkatëse, klikohet mbi butonin “Universitetet”, ku paraqiten logot e universiteteve publike dhe private.



2 - https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=854

3 - Lista e universiteteve shtetërore dhe private gjendet në Shtojcën A.

- Maturanti do të klikojë mbi logon e universitetit ku ka synim të studiojë.




- Pasi të klikohet logoja e universitetit, do të shfaqet faqja me disa tabela informuese rreth:

“Fakultetet”. Në këtë tabelë mund të zgjidhni fakultetin që jeni të interesuar për të ndjekur studimet.

“Programet e studimit”. Në këtë tabelë shfaqen programet e studimit të fakultetit që ju keni përzgjedhur në tabelën përbri.

Në tabelën e madhe, poshtë, renditen tabela të vogla me informacione rreth:

1. “Kriteret mbi mesataren”, ku jepet sqarim rreth Tipit të kriterit, Peshës dhe Shënime.
2. “Kriteret mbi lëndët”, ku jepet sqarim për: “Lënda kriter”, “Pesha”, “Ndikon” dhe “Shënime”.
3. “Shënime të tjera rreth kriterëve”
4. “Mesatarja hyrëse”
5. “Kuotat” - Renditen kuotat e shpallura.
Dhe detaje të tjera për të informuar maturantin



V.4.2. Marrja e informacionit për universitetet shtetërore dhe private

Institucionet e arsimit të lartë (IAL) kanë mundësi që të promovojnë punën e tyre dhe të rrisin njohuritë e maturantëve në lidhje me programet e studimit që ofrojnë në vitin përkatës akademik, duke u organizuar në nismën “Ditët e informimit të maturantëve”.

Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), në bashkëpunim me institucionet e arsimit të mesëm të lartë, informojnë nxënësit maturantë për datat kur IAL-të do të promovojnë dhe do të njohin nxënësit maturantë me programet e studimit që ofrojnë në vitin përkatës akademik.

ZVAP-të ngrejnë komisionin e këshillimit të karrierës pranë tyre dhe në institucionet e arsimit të mesëm të lartë dhe koordinojnë punën midis IAL-ve dhe institucioneve të arsimit parauniversitar (IAP) të arsimit të mesëm të lartë për promovimin dhe njohjen e nxënësve maturantë me programet e studimit që do të ofrohen në vitin përkatës akademik. Në këndin e këshillimit të karrierës në çdo institucion të arsimit të mesëm të lartë afishohet lista e të gjitha IAL-ve, si dhe merren masa për krijimin e kushteve dhe të infrastrukturës për takimet për promovimin dhe njohjen e nxënësve maturantë me programet e studimit që do të ofrohen në vitin përkatës akademik, pranë institucioneve të arsimit të mesëm të lartë dhe pa cenuar procesin mësimor.

Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), pasi mbledhin raportet javore të ZVAP-ve, raportojnë në DPAP për mbarëvajtjen e nismës “Ditët e informimit të maturantëve”.

V.5. Provimet e Maturës Shtetërore


Provimet e Maturës Shtetërore janë një seri provimesh që maturantët duhet të kalojnë për të marrë diplomën e shkollës së mesme në Shqipëri.

- Në vitin 2023, provimet e Maturës Shtetërore u zhvilluan në lëndët e gjuhës shqipe dhe letërsisë, matematikës, gjuhës së huaj të parë dhe një lënde me zgjedhje.
- MAS-i ka publikuar datat e provimeve të Maturës Shtetërore për vitin 2024. Në 3 qershor, maturantët do t'i nënshtrohen provimit të gjuhës së huaj, ndërsa në 10 qershor do të zhvillojnë provimin në gjuhë shqipe dhe letërsi. Në 18 qershor 2024 është caktuar provimi i matematikës, ndërsa në 24 qershor do të zhvillohet provimi i lëndës me zgjedhje.
- Nuk ka informacion në lidhje me ndryshimet e formatit të provimeve të Maturës Shtetërore për vitin 2024. Nëse dëshironi të mësoni më shumë rreth provimeve të Maturës Shtetërore, ju mund të vizitoni faqen zyrtare të Maturës Shtetërore.


V.6. U-Albania: Përzgjedhja e programeve të studimit - raundi i parë

Hapat që duhet të ndiqni për plotësimin e formularit A2:

- Aplikimi do të kryhet nga portali U-Albania, duke aksesuar në adresën: www.ualbania.al. Pasi të hapet faqja përkatëse, duhet të klikoni mbi butonin “Aplikimi A2/A3”.



- Më pas do të shfaqen dy butona të tjerë që janë: “Maturantë”, “Mbikëqyrës”. Klikoni mbi butonin “Maturant”, për të hyrë në hapësirën e maturantit.



- Pas këtij veprimi duhet që të plotësoni ID-në tuaj të maturës dhe numrin personal të letërnjoftimit (ai që fillon dhe mbaron me shkronjë), për të kryer identifikimin, teksa do t’ju hapet edhe faqja me të dhënat tuaja personale.




- Faqja përmban 3 seksione:

Seksioni i informacioneve personale

Seksioni i faturës dhe

Seksioni i aplikimit.

Në seksionin e informacioneve personale do të shikoni të dhënat tuaja.




- Në seksionin e faturës, shkarkoni faturën për arkëtim, me të cilën keni kryer pagesën në zyrat e Postës Shqiptare ose në bankë

3.2 – Shkarkimi dhe konfirmimi i faturës

Hapat që ndiqen me shkarkimin dhe konfirmimin e faturës.

Klikoni mbi butonin **“Shkarko”** dhe do ju shfaqet fatura si më poshtë



- Fatura përmban një kod 6-shifror unik (kodi i aplikimit). Ky kod ju duhet për të konfirmuar pagesën te mbikëqyrësi i shkollës dhe për të përfunduar plotësimin e preferencave.



Bëni kujdes, fatura përmban një kod 6-shifror unik (kodi i aplikimit), i cili gjenerohet për çdo faturë. Ky kod do ju duhet për të konfirmuar pagesën pranë mbikëqyrësit të shkollës, dhe për të përfunduar plotësimin e preferencave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. Faturës: 20-000015

Data: DD-MM-VVVV

Emri i institucionit përfitues: Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)
Kodi i institucionit përfitues: 1011160
Kodi i degës së thesarit ku vepron: 3535
NIPT: L12207451J
Emri Atësia Mbiemri i paguesit: Besjan Adriaqik Pasa
Nr. personal i maturantit: 82031000108

Përshkrimi i të ardhurave	Kodi Ekonomik	Tarifa e shërbimit për Student lekë	Shuma lekë
1. Pagesë për formularin e Aplikimit Universitar, Matura Shtetërore 2020	7110109	2,000	2,000

Titullari i insitucionit

Klienti

Kodi i aplikimit

000015



Drejtuar Arkëtarit: Ju lutem vendosni nr. e faturës te përshkrimi i pagesës.

Kodi i Aplikimit

Pjesa e faturës që duhet ruajtur



Klienti

Kodi i aplikimit

000015

KUJDES! Kjo pjesë e faturës duhet ruajtur deri në fund të procesit të hedhjes së preferencave në formularin A2/A3 sepse Kodi i Aplikimit do të përdoret për konfirmimin e preferencave


- Në seksionin e aplikimit mund të shikoni statusin e aplikimit tuaj. Statusi i aplikimit mund të jetë në 2 gjendje:

- Statusi kur nuk keni konfirmuar ende pagesën te mbikëqyrësi i shkollës.
- Statusi që tregon se aplikimi është konfirmuar dhe se ju keni përfunduar me sukses plotësimin e preferencave.


Aplikimi

Procedura e aplikimit nuk është hapur ende


- Pasi pagesa e faturës suaj të jetë konfirmuar, do t’ju shfaqet mesazhi “Fatura juaj është konfirmuar”.




- Tashmë, ju mund të plotësoni preferencat tuaja, fillimisht duke zgjedhur universitetin, dhe më pas, programin e studimit. Mund të plotësoni deri në 10 preferenca.



- Pasi të keni plotësuar preferencat, klikoni mbi butonin “Konfirmo”. Do t’ju shfaqet modali i konfirmimit, ku duhet të vendosni kodin e aplikimit që gjendet te kopja juaj e faturës, me të cilën keni kryer konfirmimin. Vendosni kodin e aplikimit në fushën përkatëse, dhe klikoni butonin “Konfirmo”.



- Në këtë moment, aplikimi juaj është konfirmuar dhe do t’ju shfaqet butoni “Shkarko” për të vijuar me printimin dhe ruajtjen e aplikimit. Ky hap shënon dhe fundin e aplikimit për pranimet e rëndësishme të parë.



V.7. U-ALBANIA: PËRLLOGARITJA E PIKËVE, PUBLIKIMI I LISTAVE DHE REGJISTRIMET - RAUNDI I DYTË

V.7.1. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të kandidatëve

- 1** Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, QShA-ja i përcjell RASH-it në formë shkresore dhe elektronike për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre si më poshtë:
 - a. ID-në e maturës;
 - b. të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, lloji i formularit);
 - c. notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
 - d. rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
 - e. mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
 - f. mesataren e provimeve të maturës shtetërore;
 - g. mesataren e përgjithshme të përlllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
 - h. indekset e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.

- 2** Në datën e përcaktuar në kalendar, IAL-të shkarkojnë nga portali U-Albania për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre si më poshtë:
 - b. listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
 - c. numrin personal të kandidatit;
 - d. notat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
 - e. rezultatet e provimeve të maturës shtetërore;
 - f. mesataren e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë;
 - g. mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
 - h. mesataren e përgjithshme të përlllogaritur sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare;
 - i. indekset e llojeve të institucioneve arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë.



- 3 IAL-ja kryen procesin e përlogaritjeve të pikëve për çdo kandidat, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara prej saj me vendim të Senatit Akademik IAL për çdo program studimi që ofron, publikon listat e kandidatëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përlogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe në listë, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
- 4 Brenda datave të përcaktuara në kalendar, IAL-ja afishon dhe publikon listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-të e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

Maturanti ka mundësi të ndjekë procesin e renditjes në degët ku ai ka aplikuar, nëpërmjet **“Këndit të Maturantit”**.



Mjafton që maturanti/kandidati të klikojë mbi butonin “Këndi i Maturantit” e në ndërfaqen që do të shfaqet, të shkruajë ID-në e tij të maturës. Te kjo ndërfaqe do të pasqyrohen në formën tabelore dhe në kohë reale renditja e programeve studimore të përzgjedhura prej tij.



Pasi të jeni loguar, do t’ju shfaqet tabela me preferencat tuaja. Poshtë tabelës ndodhet një sqarim dhe më poshtë ndodhet legjenda e ngjyrave që ju informon rreth domethënies së çdo ngjyre të përdorur te preferencat e renditura.

NR	Universiteti	Programi i studimit	Plikë	Rendi në klasifikim	Kuota në këtë fazë	Kuota në fazën e ardhshme	Klasifikimi në fazën e ardhshme
1	UNIVERSITETI I TIRANËS	Bioteknologji	979				
2	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	995				
3	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	145302				
4	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	145302	48	68	57	
5	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	145302	63	22	13	32
6	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inzhinieri Informatike	13692	4	59	28	
7	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturi profili Arkitekt	13680				
8	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inzhinieri Ndërtimi	13689				
9	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Pedoterapi	145302	21	19	19	18
10	UNIVERSITETI ALDENT	Stomatologji	9879	12	52	49	

SQARIM! Ju bëjmë me dije, se në këndin e maturantit nuk do të ketë vlera në kolonën "KLASIFIKIMI NE FAZEN E ARDHSHME" për preferencat me ngjyrë jeshile (fitues ose të regjistruar), sepse për këto preferenca nuk do të ketë fazë të ardhshme.


LEGJENDA E NGJYRAVE

<p>Për një nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>a) Ju jeni fitues në atë program studimi, b) Ju jeni regjistruar në atë program studimi.</p>	<p>Nuk keni fituar në këtë program studimi, për një nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>a) Ju nuk i keni aritur pikët minimale për të qënë fitues në atë program studimi,</p>	<p>Ju jeni përjashtuar nga rangimi i kësaj liste, për një nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>a) Jeni fitues në këtë program studimi por duhet të prisni për azhormimin e listës. Në fazën e fundit, ngjyra e verdhë zëvendësohet me ngjyrën jeshile dhe fituesit duhet të regjistrohen brenda 40 orëve</p>	<p>Për një nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>a) Ju jeni regjistruar në një program tjetër studimi, b) Ju keni qënë fitues në këtë program, por nuk jeni regjistruar në fazën përkatëse c) Jeni zënë të gjitha kuotat e përcaktuara për këtë program studimi</p>
--	--	--	--

V.7.2. Procesi i regjistrimit në raundin e dytë

- 1** Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
- 2** Periudha e regjistrimit është e ndarë në 5 (pesë) faza 48-orëshe, sipas afateve të përcaktuara në kalendar. Secili kandidat ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
- 3** Kandidati i shpallur fitues, duhet të paraqitet në IAL-në ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai e humbet të drejtën e regjistrimit në atë program studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.
- 4** Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të dytë, për programet e studimit, për të cilat nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare dhe numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët së numri i kuotave të miratuara.
- 5** Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 (pesë) fazave 48-orëshe, MAS-i dhe RASH-i publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare www.arsimi.gov.al dhe në portalin U-Albania <https://ualbania.al/>.

- 6 Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listën e raundit të dytë. Në rast se, pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen në fazën paraardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara, të cilat nuk kanë kandidatë në pritje, rikthehen kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi kryhet sipas listës së renditjes së kandidatëve për raundin e dytë.




- 7 Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASH-i përcjell në QShA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format shkresor dhe elektronik, me informacionet si më poshtë:

- IAL;
- njësia kryesore e IAL-së;
- cikli i studimit;
- programi i studimit;
- data e regjistrimit;
- ID e maturës;
- të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.


- 8 Kandidati, i cili ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

V.7.3. Procesi i çregjistrimit në raundin e dytë

- 1 Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-se, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim në sekretarinë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.



- 2 Sekretaritetë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar.



V.8. Klasifikimi i programeve të studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik - raundi i tretë

- a) Pas përfundimit të raundit të dytë, IAL-të, brenda 5 ditëve, përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik, programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QShA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afshohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën e përcaktuar në kalendar.
- b) Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-albania që rezultojnë të paregjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme (edhe nëse më parë nuk ka aplikuar tek ai universitet), mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave (VKM) mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të, sipas afatit të përcaktuar në kalendar.
- c) Sipas afatit të përcaktuar në kalendar, RASh-i përcjell në QShA regjistrimet përfundimtare në format shkresor dhe elektronik me informacionet si më poshtë:
- IAL;
 - njësia kryesore e IAL-së;
 - cikli i studimit;
 - programi i studimit;
 - data e regjistrimit;
 - ID e maturës;
 - të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.
- d) Kandidatët të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit për atë vit akademik

V.9. Finalizimi i regjistrimit në universitetin e përzgjedhur

Dokumentet e nevojshme për regjistrimin në Universitet

- Dokumenti i identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja.
- Fotokopja e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesa e pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave.
- Deklarata (jepet nga sekretaria e institucionit të arsimit të lartë përkatës), e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore të institucionit të arsimit të lartë përkatës dhe nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësi i sekretarisë.
- Fotografi për dokument.

V.10. Fillimi i studimeve

Fillimi i studimeve universitare mund të ndryshojë në varësi të universitetit dhe programit të studimit në të cilin jeni të regjistruar. Në përgjithësi, studimet universitare bazohen në vite akademike. Në Shqipëri, studimet fillojnë në muajin tetor dhe semestri i dytë fillon në muajin shkurt. Pas çdo semestri, që është rreth 15 javë, ka një sesion përgatitor për provimet.

Disa hapa që mund të ndiqni për të përgatitur fillimin e studimeve universitare, janë:

- 1 Konfirmimi i regjistrimit dhe regjistrimi në konvikt:**
Pas aplikimit dhe pranimit në universitet, ju duhet të konfirmoni regjistrimin tuaj duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga universiteti. Pas regjistrimit në universitet kërkoni informacion për regjistrimin në konvikt apo forma të tjera të banimit që ofron universiteti.
- 2 Përgatitja e dokumenteve dhe tarifave:**
Sigurohuni që të keni të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të keni paguar tarifat e regjistrimit në kohë.
- 3 Ndjekja e informacionit nga universiteti:**
Universiteti do t'ju dërgojë informacione të rëndësishme rreth fillimit të vitit akademik. Lexoni me kujdes të gjitha njoftimet dhe materiale informuese, si dhe ndiqni me kujdes platformat online ose digjitale duke përfshirë edhe adresat e mediave sociale që përdorin universitetet.
- 4 Familjarizimi me kursin e studimeve dhe oraret:**
Shihni orarin e kursit dhe mësoni vendndodhjen e auditorëve. Sigurohuni që të keni njohuri të mjaftueshme rreth strukturës së programit dhe orarit si edhe siguroni literaturën dhe librat e nevojshëm për lëndën.
- 5 Ndiqni seminarët orientuese:**
Mund të ketë seminare dhe sesione orientuese për studentët e rinj. Merrni pjesë në to për të ditur më shumë rreth universitetit, shërbimeve të ofruara dhe rregullave të përgjithshme.

- 6 Mësoni ku gjendet biblioteka dhe labororët me kompjuter:**
Bëni një vizitë në bibliotekë dhe informohuni rreth burimeve të studimit që do të keni në dispozicion. Ndonjëherë, mund të ketë nevojë për një kartë anëtarësimi biblioteke ose procedura të tjera për të hyrë në bibliotekë.
- 7 Kontakti me shokë e miq dhe studentë në vitet më të larta të studimeve:**
Nëse keni shokë apo miq në fakultetin që keni përzgjedhur, kontaktojini ata për të biseduar rreth fillimit të studimeve dhe për të ndarë përvojat dhe informacionin.
- 8 Përgatitja për orët e para të leksioneve dhe seminareve:**
Përgatituni mirë për orët e para të seminareve dhe ndiqni rregullisht leksionet. Lexoni materialet e caktuara, duke shqyrtuar informacionin mbi lëndën dhe pedagogun, dhe duke siguruar që të keni materiale mësimore të nevojshme.
- 9 Sigurimi i burimeve financiare për të mbështetur studimet universitare:**
Sigurohuni që të keni mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve. Nëse keni nevojë për ndihmë financiare, konsultohuni me zyrat mbështetëse në bashki apo në organizata jofitimprurëse që mbështesin studentët gjatë studimeve universitare. Merrni parasysh edhe punësimin me kohë të pjesshme për të siguruar mbulimin e shpenzimeve për jetesën dhe studimet.

Përgatitja e mirë për fillimin e studimeve është çelësi për një vazhdim të suksesshëm. Mos harroni që të konsultoheni me shërbimet që ofrohen nga universiteti për t'u përfshirë sa më mirë në komunitetin e studentëve.



VI. SHTET APO PRIVAT?

VI.1. Përfitimet e studimeve në universitetet private dhe shtetërore

Zgjedhja midis një universiteti shtetëror dhe një universiteti privat është një vendim i rëndësishëm dhe mund të varet nga shumë faktorë individualë. Në vijim kemi renditur disa aspekte që mund të merren në konsideratë kur vendosni midis universiteteve shtetërore dhe atyre private:

Universiteti shtetëror

Kosto e studimeve: Universitetet shtetërore shpesh ofrojnë tarifa më të ulëta të studimeve për studentët. Kjo mund të jetë një mundësi e mirë për të zvogëluar kostot e arsimit universitar.

Subvencionim nga shteti: Universitetet shtetërore marrin mbështetje financiare dhe subvencione nga qeveria, duke u bërë më të përballeshme për shumë studentë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështesin me bursa studimi nxënësit në bazë të kriterëve të përcaktuara

Gama e programeve të studimeve: Universitetet shtetërore shpesh ofrojnë një gamë të gjerë programesh studimi, duke përfshirë disa që janë të specializuara në fusha të ndryshme.

Diversiteti kulturor: Për shkak të numrit më të madh të studentëve, universitetet shtetërore shpesh kanë një përqindje të lartë të studentëve nga e gjithë Shqipëria dhe trojet shqipfolëse. Një pjesë e tyre tani kanë edhe programe ndërkombëtare të studimit.

Mundësitë për pjesëmarrje në kërkime dhe projekte: Universitetet shtetërore shpesh ofrojnë mundësi më të mëdha për pjesëmarrje në kërkime shkencore dhe projekte të ndryshme studimore, si Erasmus Exchange, duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike. Për më shumë informacione shikoni faqet në WEB të universiteteve të ndryshme



Universiteti privat

Mundësia për bursa dhe mbështetje financiare: Për studentët që kanë nevojë për ndihmë financiare, disa universitete private ofrojnë bursa dhe ndihma të veçanta financiare për të zvogëluar kostot e studimeve.

Klasat më të vogla dhe personalizim më i madh: Në universitetet private mund të ketë një numër më të vogël të studentëve, duke e bërë më të lehtë për studentët të kenë një marrëdhënie më të ngushtë me pedagogët dhe të përfitojnë nga një personalizim më i madh i përvojës së mësimi.

Fokusi i specializuar dhe programe të kufizuara: Disa universitete private ofrojnë programe të specializuara në disa fusha të studimit, duke ofruar një përvojë më të fokusuar në disa drejtime.

Ndërtesat dhe burimet: Universitetet private mund të kenë fonde më të mëdha për të investuar në ndërtesa, teknologji dhe burime tjera, duke ofruar një mjedis më të avancuar fizik.

Këndvështrimi i përgjithshëm dhe mësimdhënia: Universitetet private shpesh kanë një këndvështrim specifik dhe një stil tjetër për leksionet dhe seminarët duke u përqendruar më shumë në pjesën praktike dhe në përshatjen individuale



Përveç këtyre aspekteve, është e rëndësishme të konsiderohen edhe faktorët individualë, si: vendndodhja gjeografike, reputacioni i universitetit në fushën e studimit të zgjedhur dhe qëndrueshmëria financiare e universitetit. Secili prej jush ka nevojat dhe prioritetet e veta, kështu që është mirë të konsultoheni me këshilluesin e karrierës dhe të hulumtoni me kujdes para se të merrni një vendim.

VI.2. Përfitimi i bursave sipas kategorive në nevojë dhe të ekselencës në universitetet shtetërore

Studentët që ndjekin studimet universitare në institucionet publike të arsimit të lartë, mund të përfitojnë mbështetje financiare (bursë). Bursat për studentët financohen nga Buxheti i Shtetit dhe alokohen në secilin fakultet. Bursat për studentët konviktore ofrohen nga pushteti vendor vetëm për vitin e parë të studimeve, pasi ky pushtet ka një fokus mbështetjeje të nxënësit të arsimit parauniversitar. Ndaj studentët mund të aplikojnë për bursë në universitetin/fakultetin në të cilin ndjekin studimet.

Mbështetjet financiare që ofrohen për studentët, janë si më poshtë:

- Fondi i mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë.
- Programi i Mbështetjes Financiare nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
- Fondi i Ekselencës i studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë.
- Bursat për studentët që studiojnë në degë, si: mësuesia, bujqësia apo turizmi.
- Përrjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit.

VI.2.1. Fondi i mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë në universitetet shtetërore

Baza ligjore e fondit të mbështetjes financiare për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë është:

- VKM nr. 903, datë 21.12.2016, për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave (i ndryshuar me VKM nr. 397, datë 29.06.2023).

Ky fond ofrohet për:

- **Studentët e shkëlqyer**, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë.
- **Studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë**, të shpallura si të tilla me VKM. Studentët që frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

6 - Ju lutemi, kontrolloni faqen e universiteteve shtetërore për të cilat jeni të interesuar, për informacione më të përditësuara
7 - Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Lista e 40 programeve të studimit të kategorizuar si prioritete kombëtare nga qeveria e Shqipërisë, është hartuar sipas nevojave që kanë edhe universitetet, por edhe zhvillimi i vendit. Kjo listë është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

SHTOJCA NR. 1
(ndryshuar me VKM-në nr. 397, datë 29.6.2023)

Fushat e gjera të studimit	Fushat e detajuara të studimit	Programi i studimit
Arsimi	Arsimi	Arsim parashkollor
		Arsim fillor
Arte dhe humanizëm	Gjuhë dhe letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi
	Histori dhe arkeologji	Histori-Gjeografi
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji	Biologji
	Biologji Shkencat e mjedisit	Biologji-Kimi
		Studime mjedisore
	Shkencat e mjedisit Kimi	Shkenca mjedisore, profili: Menaxhim i burimeve natyrore
		Kimi
	Fizikë	Fizikë
	Matematikë	Matematikë
	Matematikë-Elektronikë dhe automatizëm	Matematikë-Fizikë
Inxhinieri	Inxhinieri matematike	
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Elektronikë dhe automatizëm Teknologjia e mbrojtjes së mjedisit	Inxhinieri fizike
	Mjete motorike, anije dhe avionë	Inxhinieri mjedisi
		Inxhinieri navale
	Mjete motorike, anije dhe avionë	Navigacion dhe menaxhim detar
	Miniera dhe industri nxjerrëse	Inxhinieri e burimeve minerare
		Inxhinieri e naftës dhe gazit
	Miniera dhe industri nxjerrëse Kultivim dhe prodhim	Inxhinieri gjeoinformatike
		Inxhinieri gjeologjike
		Inxhinieri gjeomjedis
		Inxhinieri agrare, profil: mbrojtje bimësh
Inxhinieri agrare, profil: hortikulture		
Kultivim dhe prodhim Pyje		Inxhinieri agrare, profil: agronomi
		Inxhinieri agrare, profil: agromekanizëm
		Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale
	Biologji marine dhe akuakulturë	
	Bioteknologji zooveterinare	
	Agrobiologji	
	Agrobiznes	
	Agroushqim	
	Vreshtari-Enologji	
	Inxhinieri agronomike	
Pyje	Inxhinieri pyjore	
	Inxhinieri përpunim druri	
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	Pyje	Mjekësi veterinar
	Veterinari	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hotelier-restorant, mikpritje)
Shërbime	Turizëm	Ekonomi-Turizëm
		Turizëm

8 - Vendim nr. 386, datë 01.06.2022, i Këshillit të Ministrave, për miratimin e fushave dhe programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë.

Të gjithë maturantët që kanë mesataren mbi 8.5 dhe që zgjedhin një nga këto programe prioritare, përfitojnë çdo muaj një bursë sa paga minimale. Me qëllim mbështetjen përgjatë gjithë periudhës së studimeve, edhe nëse një student vitin e parë edhe pse mund të ketë rënë nga mesatarja 8.5 në 8, ai do të vazhdojë të mbështetet me bursë edhe vitin e dytë, edhe në vitin e tretë.

Detyrimi i tyre është që pas diplomimit të qëndrojnë 3 vite, të japin kontribut për vendin. Dhe të njëjtën bursë sa paga minimale çdo muaj e përfitojnë edhe studentët ekselentë që janë me të gjitha dhjeta në maturë dhe të katërta provimet e maturës, ashtu sikurse ata që fitojnë olimpiada ndërkombëtare.

MAS-i i ndan kuotat për këto bursa sipas universiteteve. Pra, i gjithë buxheti që MAS-i ka në dispozicion për mbështetje studentore, për bursa studimi, ndahet me kuota sipas universiteteve në varësi të numrit të studentëve që ata kanë dhe të programeve të studimit që janë pjesë e listës së programeve prioritare. Më pas, vetë universitetet nëpërmjet senateve të tyre akademike, numrin total të kuotave që kanë për bursa e ndajnë në programe të ndryshme që janë prioritare sipas nevojave të tyre specifike apo zhvillimeve specifike që kanë zonat ku janë këto universitete.

AKFAL mbështetet financiarisht studentët të cilët ndjekin studimet në IAL-të publike, me qëllim për përmirësimin e arritjeve akademike, gjithpërfshirja në ndjekjen e studimeve, si dhe dhënia e bursave për studentët ekselent dhe studentët në nevojë, dhe për ata që ndjekin programe prioritare. Mbështetja Financiare është një ndër programet më të rëndësishme për mbështetjen e studentëve që ndjekin studimet në IAL-të publike, nëpërmjet së cilës Studentët e Shkëlqyer, studentët që ndjekin studimet në një nga programet prioritare dhe studentët olimpiadistë, përfitojnë bursë në masën e pagës minimale në shkallë vendi, si dhe përjashtohen nga pagesa e tarifës së studimit.

Studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë, të regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë publik.

VI.2.2. Fondi i Ekselencës për nëpunësit civilë dhe studentët e shkëlqyer në universitetet shtetërore

Fondi i Ekselencës financohet nga Buxheti i Shtetit brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme.

Baza ligjore e Fondit të Ekselencës është si më poshtë:

- VKM nr. 160, datë 19.02.2020, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)"
- Udhëzimi nr. 6, datë 04.03.2020, i MAS-it "Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë".

Nga Fondi i Ekselencës përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a Studentët, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë, kur:

- i. janë shtetas shqiptarë;
- ii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore;
- iii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës, sipas renditjes së përgjithshme për vitin përkatës të aplikimit dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, nga "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë;
- iv. pranojnë të punojnë në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve dhe diplomimit në ciklin përkatës të studimeve, për të cilin përfitojnë bursën;
- v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar.

b Studentët, të cilët ndjekin studimet e plota të doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare, kur:

- i. janë shtetas shqiptarë;
- ii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës në shkencat shoqërore dhe ekonomike ose në njërin nga 50 universitetet më të mira të botës në shkencat natyrore e teknike, sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, të "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, ose janë pranuar në njërin prej universiteteve të mirënjohura ndërkombëtare për studime në albanologji;
- iii. nuk përfitojnë financim apo shpërblim të plotë ose bursë të plotë për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës, në vlerë më të madhe se ajo e parashikuar për financim nga Fondi i Ekselencës;
- iv. pranojnë të kthehen dhe të punojnë në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve të doktoratës në fushën e studimeve të kryera;
- v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar.

c Nëpunësit civilë, të cilët ndjekin jashtë vendit një program 1-vjeçar, "Master" të ciklit të dytë apo të tretë, kur:

- i. janë shtetas shqiptarë;
- ii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës në shkencat shoqërore dhe ekonomike ose në njërin nga 50 universitetet më të mira të botës në shkencat natyrore e teknike, sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, të "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, ose janë pranuar në njërin prej universiteteve të mirënjohura ndërkombëtare për studime në albanologji;
- iii. nuk përfitojnë financim apo shpërblim të plotë ose bursë të plotë për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës, në vlerë më të madhe se ajo e parashikuar për financim nga Fondi i Ekselencës;
- iv. pranojnë të kthehen dhe të punojnë në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve të doktoratës në fushën e studimeve të kryera;
- v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar.

VI.2.3. Përrjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit në universitetet shtetërore

Baza ligjore e përrjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit në universitetet shtetërore është:

VKM nr. 269, datë 29.3.2017, për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përrjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.

Nga përrjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit në universitetet shtetërore përrfitojnë kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

- a** **Studentët me aftësi të kufizuara**, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë (KMCA) për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përrfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti e vetëqeverisjes vendore.
- b** **Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përrfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta**, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përrballimin e kostos së studimeve.
- c** Studentët, që kanë përrfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
- d** Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.
- e** Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përrfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore.
- f** Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes.
- g** Studentët romë dhe ballkano-egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale.
- h** Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përrndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.
- i** Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare vjetore 10 (dhjetë), për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përrllogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përrkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përrkatës, brenda përrfundimit të vitit akademik paraardhës.

- j** Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë) e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga QShA-ja dhe dërgohet në MAS si dhe në IAL.

VI.2.4. Masa e bursës për studentët në universitetet shtetërore

Masa e bursës së plotë mujore varion sipas kategorisë së përfituesve nga 8,900 lekë – 40,000 lekë. Masa e bursës së pjesshme mujore varion sipas kategorisë së përfituesve nga 4,450 lekë-20,000 lekë.



VI.3. Përfitimi i bursave sipas kategorive në nevojë dhe të ekselencës në universitetet private

Duke pasur si prioritet regjistrimin e studentëve me rezultate të larta, universitetet private vlerësojnë meritat e secilit prej studentëve dhe përmes programit të bursave të plota ose të pjesshme mundësojnë përkrahje financiare për studentët që do të regjistrohen në vitin përkatës akademik, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

Këto programe kanë për qëllim t'i përkrahin financiarisht studentët e ardhshëm që dëshirojnë të marrin dije profesionale dhe aftësi cilësore përmes vijimit të programeve studimore në universitetet private.

Studentët mund të aplikojnë për bursë në universitetin/fakultetin në të cilin ndjekin studimet.

Llojet e bursave që ofrohen në universitetet private variojnë sipas universitetit, por në përgjithësi kategorizimi i tyre është si më poshtë:

- a. Bursat e ekselencës
- b. Bursat e promovimit
- c. Bursat sociale
- d. Bursat e talentit dhe lidërshiptit.

VI.3.1. Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer në universitetet private

Nga Fondi i Ekselencës përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

- a Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë.
- b Studentët e shkëlqyer, që kanë mbaruar vitin akademik pararendës në universitet me notë mesatare maksimale

VI.3.2. Bursat e promovimit në universitetet private

Nga bursat e promovimit përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

- a Studentët me notë mesatare mbi 8.5 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë.
- b Studentët, që kanë mbaruar vitin akademik pararendës në universitet me notë mesatare mbi 8.5 .

9 - Ju lutemi, kontrolloni faqen e universiteteve private për të cilat jeni të interesuar, për informacione më të përditësuara.

10 - Aplikuar në disa universitete private, si: UET, Polis, Mesdhetar i Shqipërisë, Kolegji Universitar i Biznesit, Bedër, Tirana Esthetics & Style School

VI.3.3. Bursat sociale për studentët në universitetet private

Nga fondi i bursave sociale përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

- Studentët që u përkasin shtresave vulnerabël të shoqërisë:
 - për fëmijët e policit ose ushtarakut të rënë në detyrë;
 - jetimët deri në moshën 25 vjeç;
 - ata që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë;
 - personat me aftësi të kufizuara;
 - ata që vetë deklarojnë/vërtetojnë se janë romë apo ballkano-egjiptianë.
- Studentët që janë anëtarë të familjeve në nevojë ekonomike.
- Studentë nga e njëjta familje, me lidhje familjare: motër – vëlla; motër – motër; vëlla – vëlla; prind – fëmijë të cilët janë në të njëjtën certifikatë familjare; dhe burrë – grua.

VI.3.4. Bursat e talentit dhe lidershipit

Bursat e talentit jepen në disa universitete private për studentët që tregojnë se kanë prirje dhe arrijnë të spikatin në fusha të ndryshme, si: arti, politika, sporti, shkenca, lidership dhe olimpiada.

VI.3.5. Masa e bursës për studentët në universitetet private

Masa e bursës së ekselencës apo sociale ndryshon nga njëri universitet në tjetrin. Masa e bursës së plotë vjetore varion nga 1150 euro - 3000 euro në fakultete të ndryshme. Masa e bursës së pjeshme vjetore varion nga 300 euro - 1500 euro në fakultete të ndryshme.

VI.4. Përzgjedhja e studimeve në Tiranë apo në rrethe?

Zgjedhja midis studimit në kryeqytet apo qytet shumë të madh, si Tirana, dhe në një universitet rajonal është një vendim që varet nga shumë faktorë individualë. Këtu janë disa aspekte që mund t'ju ndihmojnë të vendosni:

11 - Në universitete/fakultete të ndryshme nota mesatare e përfitimit të bursës është 8.5-10.

12 - Kjo aplikohet në disa universitete private, si: Polis, Mesdhetar i Shqipërisë, Aldent

Për studim në Tiranë

Gama e universiteteve dhe programeve të studimit: Qyteti i Tiranës dhe bashkitë që e rrethojnë ofrojnë një gamë të gjerë programesh studimi në universitetet dhe institucionet e saj. Në Tiranë kanë kampuset e tyre të paktën 8 universitete shtetërore dhe rreth 20 private. Kjo mund t'ju japë mundësi të zgjidhni nga një shumëllojshmëri e madhe programesh studimi.

Mundësi për aktivitete shtesë dhe punësim e zhvillim karriere: Një qytet i madh si Tirana ofron shumë mundësi për pjesëmarrje në aktivitete shtesë, vullnetarizëm, jetë aktive shoqërore, praktika pune dhe orientim e lidhje në fushën e punësimit.

Kampuset, konviktet dhe shërbimet për studentët: Universitetet në Tiranë mund të kenë infrastrukturë më të zhvilluar dhe burime më të mëdha, duke përfshirë auditorë të rinovuar, biblioteka të pasura dhe mjedis të përshtatshme mësimore.

Ndikimi në jetën kulturore dhe Shoqërore: Jetesa në një qytet të madh ka ndikim në jetën kulturore, shoqërore dhe artistike. Ju keni mundësi të eksploroni shumë ngjarje dhe aktivitete që sjellin një përvojë më të pasur sociale dhe kulturore.

Mundësi për punë dhe punë të pjesshme gjatë studimeve: Në Tiranë ka mundësi më të shumta për punë part-time apo praktika pune për studentët, duke ofruar një mundësi të mirë për zhvillimin e aftësive praktike dhe përvojën profesionale.



Për studim në universitet rajonal

Më pak kosto: Studimi në universitetet rajonale mund të jetë më ekonomik se në qytete më të mëdha si Tirana. Kostoja e jetesës dhe qiraja janë më të ulëta në zona më të vogla dhe ato zvogëlohen edhe më shumë nëse vazhdoni të jetoni pranë familjes, me prindërit tuaj.

Përvojë studimore më e personalizuar dhe e ngushtë: Universitetet rajonale zakonisht kanë një numër më të vogël studentësh, duke ju ofruar një mjedis më të ngushtë dhe më të personalizuar për mësim.

Marrëdhënie më e mirë me pedagogët: Me një numër më të vogël studentësh, mund të keni një marrëdhënie më të mirë me pedagogët dhe mundësi më të mëdha për të bërë pyetje dhe për të marrë mbështetje individuale

Fokus në komunitetin lokal: Studimi në një universitet rajonal mund t'ju ofrojë një fokus më të madh në komunitetin lokal dhe mund t'ju bëjë të ndiheni më pjesë komunitetit profesional rajonal.

Më pak konkurrencë: Në universitetet rajonale, konkurrenca shpesh është më e ulët se në qytetet më të mëdha, duke ju mundësuar të përfitoni më shumë nga burimet e disponueshme.



Zgjedhja midis studimit në Tiranë dhe në një universitet rajonal varet nga preferencat tuaja personale, qëllimet akademike dhe të punësimit si dhe aspektet financiare dhe sociale. Konsideroni hollësitë e çdo alternative dhe mundohuni të shqyrtoni më thellë përvojat dhe mundësitë që mund të ofrojë për ju secili universitet.

VII. SHTOJCA

VII.1. Shtojca A - Informacion për universitetet

VII.1.1. Universitetet shtetërore në Shqipëri

1. UNIVERSITETI I TIRANËS: <https://unitir.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë** <https://fdut.edu.al/>
- b. **Fakulteti i Ekonomisë** <https://feut.edu.al/>
- c. **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja** <https://fgjh.edu.al/>
- d. **Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë** <https://www.fhf.edu.al/>
- e. **Fakulteti i Shkencave Sociale** <https://fshs-ut.edu.al/>
- f. **Fakulteti i Shkencave të Natyrës** <https://fshn.edu.al/>

2. UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS <https://upt.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës** <https://fau.edu.al/>
- b. **Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave** <https://fgjm.edu.al/>
- c. **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike** <https://fe.edu.al/>
- d. **Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike** <https://fimif.edu.al/>
- e. **Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike** <https://www.fim.edu.al/>
- f. **Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit** <https://fn.edu.al/>
- g. **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit** <https://www.fti.edu.al/>

3. UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS <http://umed.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Mjekësisë** <https://www.fakultetimjekesise.edu.al/>
- b. **Fakulteti i Mjekësisë Dentare** <https://fmd.edu.al/>
- c. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike** <https://fshmt.umt.rash.al/>

4. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS <https://www.ubt.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit**
- b. **Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit**
- c. **Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit**
- d. **Fakulteti i Mjekësisë Veterinare**
- e. **Fakulteti i Shkencave Pyjore**

5. UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS <https://uamd.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Biznesit**
- b. **Fakulteti i Edukimit**
- c. **Fakulteti i Studimeve Profesionale**
- d. **Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike**
- e. **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**
- f. **Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën**

6. UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR <https://unishk.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**
- b. **Fakulteti i Shkencave të Edukimit**
- c. **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**
- d. **Fakulteti i Drejtësisë**
- e. **Fakulteti Ekonomik**
- f. **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

7. UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN <https://www.uniel.edu.al/bashkepunime>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Ekonomik**
- b. **Fakulteti i Shkencave Humane**
- c. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**
- d. **Fakulteti i Shkencave të Edukimit**
- e. **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**

8. UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË <https://univlora.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë**
- b. **Fakulteti i Shëndetit Publik**
- c. **Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë**
- d. **Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore**

9. UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË <https://unkorce.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Bujqësisë**
- b. **Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë**
- c. **Fakulteti i Ekonomisë**
- d. **Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane**

10. UNIVERSITETI "EQEREM ÇABEJ" GJIROKASTËR <https://uogj.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Ekonomik**
- b. **Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore**
- c. **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**

11. UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS <http://uart.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Arteve të Bukura**
- b. **Fakulteti i Artit Skenik**
- c. **Fakulteti i Muzikës**

12. UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS <https://ust.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes**
- b. **Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit**
- c. **Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit**

13. AKADEMIJA E FORCAVE TË ARMATOSURA <https://www.tradoc.mil.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë**



VII.1.2 Universitetet Private në Shqipëri

1. UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS <https://uet.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit**
- b. **Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës**
- c. **Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale**
- d. **Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare**
- e. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**

2. UNIVERSITETI "LUARASI" <http://luarasi-univ.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Ekonomik**
- b. **Fakulteti i Drejtësisë**
- c. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**
- d. **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit**

3. UNIVERSITETI "POLIS" <https://universitetipolis.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn**
- b. **Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim**
- c. **Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban**

4. UNIVERSITETI "EPOKA" <https://www.epoka.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë**
- b. **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale**
- c. **Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative**

5. UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA <https://unyt.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore**
- b. **Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit**
- c. **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës**

6. UNIVERSITETI KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË" <https://www.unizkm.al/al>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Farmacisë**

- b. **Fakulteti i Mjekësisë**
- c. **Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale**
- d. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara**

7. UNIVERSITETI PRIVAT "ALBANIAN UNIVERSITY" <https://albanianuniversity.edu.al/sq/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**
- b. **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**
- c. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike**

8. UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË <https://www.umsh.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane**
- b. **Fakulteti i Informatikës**
- c. **Fakulteti i Shkencave Ekonomike**
- d. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

9. KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË" <https://sq.cit.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë**
- b. **Fakulteti i Inxhinierisë**

10. TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE <https://tbu.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë**
- b. **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**

11. UNIVERSITETI "ALDENT" <https://ual.edu.al/ual.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Shkencave Dentare**
- b. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**

12. UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA <https://umt.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë**
- b. **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës**
- c. **Fakulteti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT**

13. KOLEGJI UNIVERSITAR "WISDOM" <https://wisdom.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë**
- b. **Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore**
- c. **Programet 2-vjeçare me karakter profesional**

14. KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS" <http://www.kulogos.edu.al/al/index.html>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Ekonomik**
- b. **Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor**
- c. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara**

15. KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS <https://kolegjiprofesional.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Departamenti Elektromekanikë dhe Sisteme të Aplikuara**
- b. **Departamenti i Teknologjisë së Informacionit**

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike**
- b. **Fakulteti i Ekonomisë**
- c. **Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale**

17. AKADEMIJA "IVODENT" <https://ivodent.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Teknikave Dentare**

18. UNIVERSITETI "BARLETI" <https://www.umb.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë**
- b. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**
- c. **Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit**
- d. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative**

19. KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" <https://qiriaz.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Drejtësisë**
- b. **Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit**
- c. **Fakulteti i Ekonomisë**
- d. **Kolegji Profesional i Lartë**

20. KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR" <https://www.beder.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë**
- b. **Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit**

21. KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD" <https://unireald.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë**
- b. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

22. AKADEMIJA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS "MARUBI" <https://afmm.edu.al/sq/>

Fakultetet:

- a. **Film dhe Media**

23. AKADEMIJA "NEHEMIAH GATEWAY" <https://www.nehemiah-gateway.al/en>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti Biznes dhe Teknologji**

24. TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL <https://tess.al/>

Fakultetet:

- a. **Departamenti i Estetikës dhe Nutricionit**
- b. **Departamenti i Kozmetologjisë**

25. KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË GJERMAN I TEKNOLOGJISË <https://kpgjt.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i KPGJT**

26. UNIVERSITETI "WESTERN BALKANS" <https://wbu.edu.al/>

Fakultetet:

- a. **Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit**
- b. **Fakulteti i Mjekësisë Dentare**
- c. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**

VII.2. Shtojca B - Referenca

1. e-albania, (2023), Matura Shtetërore

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=854

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, (2023), Udhëzim: Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë.

<https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2023/06/udhezimi-nr.12-2023.pdf>

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit, (2023), Urdhër: Për miratimin e formularëve A1/A1Z dhe udhëzuesve përkatës për Maturën Shtetërore dhe maturën shtetërore profesionale 2023

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/MAS/854/urdher_per_miratimin_formulareve_dhe_udhezuesve_2023.pdf

4. U-Albania, (2023), Portali i aplikimit universitar: Kalendar i aplikimit universitar 2023

<https://ualbania.al/>



e-albania, (2023),
Matura Shtetërore



Ministria e Arsimit dhe
Sportit, (2023),
Udhëzim: Për procedu-
rat e aplikimit dhe të
regjistrimit në
institucionet e arsimit
të lartë.



Ministria e Arsimit
dhe Sportit, (2023),
Urdhër: Për miratimin
e formularëve A1/
A1Z dhe udhëzuesve
përkatës për Maturën
Shtetërore dhe
maturën shtetërore
profesionale 2023



U-Albania, (2023),
Portali i aplikimit
universitar: Kalendar
i aplikimit universitar
2023



*Udhëzuesi për përzgjedhjen
e studimeve në universitetet
publike dhe private
në Shqipëri*





JANAR, 2024